



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

**Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në “Financë,
Bankë, Sigurime dhe Pasuri të Paluajtshme”**

ofruar nga

Institucioni i Arsimit të Lartë “Universiteti Barleti”

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1. Prof.Dr.Sherif Bundo

2. Prof.Dr. Drini Salko

Prill 2023

RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Për programin e studimit Bachelor në “Financë, Bankë, Sigurime dhe Pasuri të Paluajtshme” ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë “Universiteti Barleti”

Nr.		
1	IAL aplikues:	Universiteti “Barleti”
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Ekonomisë, Sipërmarrjes dhe Financës
3	Emërtimi i programit të studimit:	Bachelor në “Financë, Bankë, Sigurime dhe Pasuri të Paluajtshme”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	UMASR Nr. 546, datë 10.09.2018
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	-
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	-
8	Cikli i studimit:	Cikli i parë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 vite
10	Kreditet në total (ECTS):	180 ECTS
11	Forma e studimit:	Kohë e plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 6
17	Stafi akademik PAE/ PAK për programin e studimit (2021- 2022):	15 PAE/ 7 PAK
18	Numri i studentëve:	v.a 2019- 2020: 8 studentë v.a 2020- 2021: 8 studentë v.a 2021- 2022: 5 studentë (2 larguar) v.a 2022- 2023: 4 studentë Totali: 23 studentë
19	Komente / të tjera:	-

PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Universiteti "BARLETI" (UB) ka nisur veprimtarinë e tij si Institucion i Arsimit të Lartë jopublik në Shqipëri bazuar në VKM nr.571.date 12.08 2005. UB ushtron veprimtarinë e tij në baze të akteve ligjore, nënligjore dhe kuadrit rregullator të brendshëm. që nga kjo periudhe UB ka zgjeruar aktivitetin e tij dhe sot në përbërjen e tij operojnë 4 Fakultete si njësi kryesore. Fakulteti i Ekonomisë Qeverisjes dhe Drejtësisë (FEQD) si një nga këto katër fakultete është njëkohësisht dhe njësi kryesore përgjegjëse e programit Bachelor në Finance Banke Sigurime dhe Pasuri të Paluajtshme (FBSPP) . FEQD përfshin 3 departamente në strukturën e tij ku Departamenti i Ekonomisë Sipërmarrjes dhe Financës është njësi baze përgjegjëse e këtij programi studimi.

Programi i studimit Bachelor në "FBSPP" i miratuar me vendim Senati të UB nr.1110/18 date 30.03.2018, është licencuar me urdhër të Ministrisë Arsimit Sportit dhe Rinisë (MASR) Nr. 546, datë 10.09.2018. Programi i studimit ofrohet në gjuhën shqipe dhe ka për qëllim përgatitjen e specialistëve në fushën e financës bankës, sigurimeve dhe pasurisë së paluajtshme duke i specializuar në këto drejtime të tregut të punës të diplomuarit në këtë program. Programi i studimit realizohet me 180 kredite dhe kohëzgjatja normale është tre vite akademike. Programi i studimit Bachelor në "FBSPP" është organizuar në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi, VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 "*Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga IAL*".

Qëllimi i programit të studimit siç përcaktohet nga vetë institucioni është pajisja e studentëve me "njohuri gjithëpërfshirëse mbi financën, bankën sigurimet dhe pasuritë e paluajtshme vendimmarrjen dhe mjetet e zbatimit të funksionit financiar, në të gjithë tipet e sipërmarrjes, nga ndërmarrjet klasike, përfshirë ndërmarrjet "banka" dhe "sigurime " deri tek njohuritë mbi vlerësimin dhe menaxhimin e pasurive të paluajtshme ”.

Programi i studimit ofrohet nga DESF që ofron programe studimi në ciklin e parë dhe ciklin e dytë dhe ka një eksperiencë të gjatë në lidhje me ofrimin e programeve në fushën e financës duke aplikuar e përfshirë në kurikulat e veta lëndë sipas kërkesave të tregut të punës. Në vitin akademik 2021-2022 departamenti përbehej nga 13 PAE dhe 20 PAK. Në vitin akademik aktual 2022-2023 departamenti ka në përbërjen e tij 13 PAE dhe 13 PAK. Personeli me kohë të plotë krahas angazhimit në mësimdhënie, është i përfshirë dhe në punë kërkimore-shkencore në funksion të mësimdhënies dhe zhvillimit ekonomik lokal/ kombëtar.

DEFS, bashkëpunon me institucione të tjera të arsimit të lartë (kombëtare dhe ndërkombëtare) në fushën e mësimdhënies, organizimit të konferencave shkencore dhe pjesëmarrjen si partnerë në projekte të ndryshme. Departamenti bashkëpunon gjithashtu me institucione të tjera private dhe publike për arritjen e objektivave të tij në fushën e mësimdhënies dhe të kërkimit.

PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM;


Grupi i Vlerësimit të Jashtëm, i përbërë nga Prof.Dr.Sherif BUNDO dhe Prof. Dr. Drini SALKO, i miratuar nga Bordi i Akreditimit dhe ASCAL, është mbështetur në këtë proces nga koordinatori teknik i ASCAL znj. Aviola BARDHI, në realizimin e procesit të vlerësimit të jashtëm; u mbështet në një seri dokumentesh dhe kërkesash të ndryshme në lidhje me standardet dhe mënyrën e funksionimit të njësive përkatëse që mbulojnë këtë program. Burim i rëndësishëm për vlerësimin e jashtëm shërbeu Raporti i Vlerësimit të Brendshëm, i cili është rezultat i bashkëpunimit ndërmjet stafit akademik dhe atij administrativ dhe pasqyron situatën e procesit të formimit dhe të zhvillimit në FEQD, si dhe në DESF. Një rol të rëndësishëm në këtë vlerësim pati vizita në vend që u realizua pranë UB, dhe FEQD në datat 6 dhe 7 Mars 2023. Në bazë të agjendës së përgatitur paraprakisht dhe të dakordësuar me institucionin (UB dhe FEQD), u realizuan takime me drejtues të njësisë kryesore/bazë e struktura të tjera të këtij institucioni, ku u verifikuan dhe u shqyrtuan edhe një sërë dokumentesh të dosjes përkatëse të aplikimit për akreditim të këtij programi.

Gjatë vizitës në Institucion u realizuan takime me: Dekanin e Fakultetit të Ekonomisë, Përgjegjës të DESF, Grupin e Vetëvlerësimit të Brendshëm, stafin akademik që mbulon programin e studimit, studentët, Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Zyrën e Kurikulës dhe Cilësisë, Zyrën e Këshillimit të Karrierës dhe Alumni, Zyrën e Shërbimit të Studentëve, Zyrën e Marrëdhënive me Jashtë, Zyrën e Hartimit dhe Menaxhimit të Projekteve, Zyrën e Burimeve Njerëzore dhe Sekretarinë Mësimore. Gjithashtu, u realizua një vizitë edhe në mjediset mësimdhënëse të këtij Institucioni, sallën e kompjuterëve, bibliotekë, etj.

Në verifikimin e të dhënave u përdor metoda e marrjes së mostrës, duke nxjerrë në mënyrë të rastësishme kampionët për verifikim. Kjo metodë u përdor në verifikimin e të dhënave lidhur me cilësinë e studentëve, të dhënat e studentëve në sekretari, të dhënat për hyrje dhe dalje të studentëve në vite, lidhur me frekuentimin e leksioneve dhe të seminareve, verifikimin e praktikave të rekrutimit të stafit, etj. Së fundmi, vlerësojmë bashkëpunimin me të gjithë strukturat përkatëse të Institucionit që na mundësuan plotësimin e kërkesave tona për dokumentacion shtesë, lidhur me aspekte të caktuara në shërbim të një vlerësimi sa më objektiv.

Raporti është hartuar në bashkëpunim të ngushtë midis dy ekspertëve të jashtëm dhe paraqet mendimet e tyre të integruara.

Më datë 13.04.2023, përmes sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare Nr 13/46 Prot., datë 13.04.2023 dërgohet në Institucion Draft- Raporti i Vlerësimit të Jashtëm. IAL përcolli komentet, përmes AMS, më datë 19.04.2023 dhe me shkresë zyrtare Nr 486 Prot., datë 19.04.2023.



GVJ pasi u njoh me komentet e Institucionit mbi draft- raportin, sqaron si vijon:

**GVJ në Fusha IV, -Standardi IV.1, Kriteri 1 dhe konkluzioni.
Vlerësimi i eksperteve**

Kriteri 1

Mendojmë që institucioni të shikojë mundësinë të rritjes së peshës specifike në mësimdhënie të PAE si dhe të rrisë kualifikimin e tij me shume anëtarë që zotërojnë grade shkencore apo titull akademik.

Konkluzioni:

GVJ bazuar në dokumentacionin e ofruar nga institucioni si dhe vizitën e realizuar në institucion konkludon se megjithëqë rritjen e numrit të stafit akademik nga viti në vit që nga fillimi i tij, institucioni duhet të beje përpjekje paralele që krahas rritjes së numrit të studenteve të regjistruar të rrisë dhe numrin e PAE dhe për rrjedhojë edhe ngarkesën mësimore që ata mbulojnë. Gjithashtu duhen bere përpjekje edhe për rritjen e kualifikimit akademik të tyre me zotërim tituj akademik.

Koment nga GVB: Duke u nisur nga rekrutimet e zhvilluara vitin e fundit akademik, departamenti është rinovuar me staf akademik PAE, i cili përbehet nga 8 anëtarë me gradën Prof.Dr. Prof.As.Dr dhe Doktor Shkencave , 3 anëtarë të tjerë janë në proces doktrate (Lista e stafit akademik).

Në këtë vit akademik me rekrutimin e stafit të ri është rritur numri i artikujve dhe konferencave shkencore në kuadër të rritjes dhe zhvillimit akademik të stafit me kohe të plote(PAE) (Analiza semestrale për kërkimin shkencor).

Komentet nga GVJ: Për sa më sipër duke vlerësuar rritjen e PAE të departamentit në vitin aktual akademik, theksojmë se rekomandimi jonë i referohet personelit akademik të angazhuar në këtë program angazhimi e PAK është pothuajse në të njëjtin nivel me vitin akademik 2021-2022.

Vlerësimi i kriterit nuk ndryshon

**GVJ në Fusha VI, -Standardi VI.1,
Vlerësimi i eksperteve**

Kriteri 1

Ndërkohë nuk rezulton që të jenë bërë analiza të posaçme për programin e studimit bachelor në FBSPP nga departamenti apo nga Dekanati i Fakultetit.

Koment nga GVB: Bëjmë me dije se këtë vit u be për here të pare studimi i tregut të punës dhe plani strategjik për zhvillimin e këtij programi, e cila inicioi ndryshimet në rang departamenti që preken dhe programin në fjale. Për arsye procesi akreditimi plani për zhvillimin e programit të studimit dhe të programeve të tjera është gati dhe ndryshimet do evidentohen në vitin e ardhshëm akademik.

Komentet nga GVJ: Për sa më sipër sqarojmë se vlerësimi ynë i referohet periudhës deri në fillim të këtij procesi duke evidentuar situatën aktuale. Si rrjedhojë vlerësimet tona qëndrojnë

Vlerësimi i kriterit nuk ndryshon

LISTA E SHKURTIMEVE

ASCAL	Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë
DESF	Departamenti i Ekonomisë ,Sipërmarrjes dhe Financës
FEQD	Fakulteti i Ekonomisë Qeverisjes dhe Drejtësisë
FBSPP	Financë, Bankë, Sigurime dhe Pasuri të Paluajtshme
IAL	Institucion i Arsimit të Lartë
GVB	Grupi i Vlerësimit të Brendshëm
GVJ	Grupi i Vlerësimit të Jashtëm
NJSBC	Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë
RVB	Raport i Vlerësimit të Brendshëm
NJZHKC	Njësia e Zhvillimit të Kurrikulës dhe Cilësisë
UB	Universiteti Barleti
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
ZKA	Zyra e Karrierës dhe Alumni
ZMBNJ	Zyra e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore

Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në “Financë, Bankë, Sigurime dhe Pasuri të Paluajtshme”

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMEVE


Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij, me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit, e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Programi i studimit të Ciklit të Parë Bachelor në “Financë, Bankë, Sigurime dhe Pasuri të Paluajtshme” (FBSPP) që ofrohet nga Universiteti Barleti (UB) nuk bie ndesh me interesa kombëtare. Programi bazohet në Statutin e institucionit si dhe përkon edhe me zhvillimin institucional, akademik dhe shkencor të përcaktuara në strategjinë e UB për periudhën 2020-2030. Studentet që përfundojnë këtë program kane mundësi që në kuadër të zhvillimeve ekonomiko sociale të dekadës së fundit të jene pjese e tregut të punës në funksion të kontributit të tyre në nivel lokal, rajonal apo edhe kombëtar. <i>Evidence nr 1. Statuti i UB</i> <i>Evidencë nr. 3.Strategjia e zhvillimit Institucional 2020-2030</i>
Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Ky program bazohet në përputhje me qëllimin dhe misionin e UB dhe fushën e veprimtarisë së tij. Këtë e bazojmë mbështetur në shqyrtimin dokumentacionit themelore të institucionit si statutin (neni 4 ; neni 5; neni 6 dhe neni 7), strategjie e hartuar nga institucioni (pika 3.1 dhe 3.2) dhe kuadrin rregullator të tij në nivel institucional , njësie kryesore dhe njësi bazë (neni 2 dhe neni 3) <i>Evidence nr 1. Statuti i UB</i> <i>Evidencë nr. 3.Strategjia e zhvillimit Institucional 2020-2030</i>
Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit si dhe me fushat e drejtimet akademike të tij.	Programi i studimit të Ciklit të Parë Bachelor në FBSP që ofrohet nga UB është bazuar në dokumentet themelore të zhvillimit institucional. Ky program është në funksion të zbatimit të vizionit, prioriteteve dhe objektivave të vendosura në Strategjinë e zhvillimit institucionale të periudhës 2020- 2030 (pika 4.3.3.2). Kështu, mund të përmendim objektivin strategjik 1.2 si dhe në piken pese planin e zbatimit në të cilin theksohet rritja 20% e nr të studenteve ashtu edhe konsolidimi dhe funksionimi i programeve ekzistuese dhe programeve të reja studimore. Edhe në rregulloren e institucionit përcaktohen shtyllat e zhvillimit të UB (neni nr.4) <i>Evidence nr 1. Statuti i UB</i> <i>Evidence nr.2. Rregullore e UB</i> <i>Evidencë nr. 3.Strategjia e zhvillimit Institucional 2020-2030</i>
Kriteri 4. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.	UB ka tashme rreth 18 vite që operon si institutin i arsimit të lartë jopublik në Shqipëri dhe ka krijuar profilin e tij të qëndrueshëm me ofrimin e programeve bashkëkohore dhe cilësore. Institucioni krahas përvojës ofron edhe kapacitete dhe burime të mjaftueshme akademike për të realizuar programet e studimit që zhvillohen aktualisht dhe që kane ardhur në vite duke u rritur në numër por edhe në cilësinë që ofrojnë. Një zhvillim mjaft

	<p>i rëndësishëm është edhe përmirësimi i dukshëm dhe ofrimi i një infrastrukture mjaft të mire për zhvillimin e programeve mësimorë të ofruara ku përfshihet edhe programi i studimit Bachelor në FBSPP.</p> <p><i>Evidence nr 1. Statuti i UB</i></p> <p><i>Evidence nr.21. Veprimtaria kërkimore, Monitorimi dhe Rezultatet në UB</i></p>		
<p>Kriteri 5. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>Ky program studimi i ofrua nga DESF si njësi baze tashme i licencuar nga MASR me vendimin nr.546 date 10.09.2018 ka në fokus fushën e gjerë të financës, bankës, sigurimeve dhe pasurisë se paluajtshme. Këto fusha përkojnë me veprimtarinë e Fakultetit të Ekonomisë, Qeverisjes dhe Drejtësisë (FEQD) si njësi kryesore dhe DESF si njësi baze.</p> <p>Programi nuk është kodifikuar në zbatim të VKM.nr.310 date 11.05.2022”</p> <p>Për specifikimet dhe përmbajtjen e kodifikimit të programeve të studimit” si dhe udhëzimit në funksion të këtij vendimi nr.31.datë 15.11.2022 .</p>		
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ bazuar në dokumentacionin e ofruar nga institucioni si dhe vizitën e realizuar në institucion konkludon se program i studimit Bachelor në FBSPP është në përputhje me misionin dhe qëllimin e veprimtarisë të UB duke ruajtur interesat dhe vlerat kombëtare.</i></p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X

<p>Standardi I.2</p> <p>Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësisë profesionale, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësisë e personelit, marrjes së përgjegjësisë përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>Hartimi i programit Bachelor në FBSPP është paraprirë nga diskutimi dhe konsultimi i DESF me strukturat e tjera të institucionit dhe informacionin marre nga aktorë të tregut të punës. në evidentuam dokumentin e argumenteve të hapjes se këtij programi që i parapriu aplikimit për marrjen e licencës nga MASR në vitin 2018. Miratimi i programit është fryt i bashkëpunimit të strukturave brenda UB dhe ndarja e detyrave dhe përgjegjësisë mes njësisë kryesore, njësisë baze dhe gjithë strukturave mbështetëse të programit janë të sanksionuar në një sere aktesh rregullative dhe mbikëqyrëse si rregullore e UB, rregullore e programit të studimit Bachelor në FBSPP. në këto dokumente janë të përcaktuar qarte drejtimit e bashkëpunimit dhe ndarja e përgjegjësisë të gjitha njësisë përkatëse. Me marrjen e licencimit nga MAS njësi baze dhe kryesore e UB kane marre gjithë përgjegjësinë e zhvillimit të programit të studimit duke analizuar dhe evidentuar edhe ecurinë e programit .</p> <p><i>Evidence. Argumentimi i hapjes se programit Bahelor në FBSPP (dokument në aplikim për licencë pranë MAS)</i></p> <p><i>Evidence nr.1.3. Rregullore e DESF</i></p> <p><i>Evidence nr.32. Raport i mbledhjes se DESF</i></p>

	<i>Evidence nr.34. Analiza vjetore e DESF</i>			
Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ ose të huaj.	Bazuar në dokumentacionin e aplikimit të institucionit shohim se UB gjate dy viteve të fundit ka qene mjaft aktiv duke nënshkruar rreth 80 marrëveshje apo memorandum bashkëpunimi me institucione homologe, brenda dhe jashtë vendit si dhe aktore të biznesit, institucione publike etj. Këto marrëveshje janë në funksion të realizimit të objektivave të procesit mësimor dhe lidhen si me angazhimin e specialisteve të këtyre organizatave në ofrimin e eksperiencës ashtu edhe në mundësinë e realizimit nga studentet të praktikës mësimore pranë tyre. Ne funksion të këtij program janë rreth 30 marrëveshje bashkëpunimi. <i>Evidence, Aneks 7. Marrëveshje bashkëpunimi dhe memorandume nënshkruar dy vitet e fundit.</i> <i>Evidence .Aneks tabelash (tabela nr.5)</i>			
Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj.	Bazuar në listën e marrëveshjeve të bashkëpunimit mes UB dhe institucioneve të tjera apo aktoreve të sipërmarrjes shikojmë se një numër i konsiderueshëm e tyre ofrojnë mundësinë e realizimit të praktikave profesionale për studentet e këtij program. Nisur edhe nga numri i ulet i studenteve në këtë program këto marrëveshje janë mese të mjaftueshme në funksion të këtij qëllimi. <i>Evidence nr.22. Politika e bashkëpunimit dhe marrëveshjet e partneritetit</i> <i>Evidence, Aneks 7. Marrëveshje bashkëpunimi dhe memorandume nënshkruar dy vitet e fundit.;</i> <i>Evidence .Aneks tabelash (tabela nr.5)</i>			
Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit paraqitur për aplikim pranë ASCAL-it si dhe nga takimi në institucion rezulton se DESF analizon dhe shqyrton në raportet periodike edhe ecurinë dhe realizimin e marrëveshjeve në funksion të programit si nëpërmjet kontakteve me partnerë ashtu edhe në takime të specialisteve të këtyre të fundit me stafin dhe studentet. <i>Evidence nr.22. Politika e bashkëpunimit dhe marrëveshjet e partneritetit</i> <i>Evidence , Aneks 7. Marrëveshje bashkëpunimi dhe memorandume nënshkruar dy vitet e fundit. Evidence .Aneks tabelash (tabela nr.5)</i>			
Konkluzione	<i>GVJ bazuar në dokumentacionin e ofruar nga institucioni si dhe vizitën e realizuar në institucion konkludon se program i studimit Bachelor në FBSP bazohet në një numër të konsiderueshëm marrëveshjesh bashkëpunimi mes UB dhe institucioneve apo sipërmarrjeve të ndryshme duke mundësuar realizimin e praktikës profesionale dhe marrjen e eksperiencës nga specialiste të fushës jashtë UB.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X


Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X



II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR

Standardi II.1	
Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në “FBSPP “që ofrohet nga Departamenti i Ekonomisë, Sipërmarrjes dhe Financës (DESF) i Fakultetit të Ekonomisë Qeverisjes dhe Drejtësisë (FEQD) pranë UB është i organizuar në 27 lëndë (përfshire praktiken profesionale) dhe 30 module të cilat vlerësohen me kredite përkatëse në përputhje me VKM Nr. 41, datë 21.01.2018 “<i>Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë</i>”, i ndryshuar, ku lëndët e modulet vlerësohen me sistemin e krediteve ECTS dhe orë. Programi bazohet në Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ETCS) dhe parimeve të Kartës së Bolonjes. Programi me një kohëzgjatje 3 vite akademike e ndarë në 6 semestra dhe që përfshin 180 ECTS.</p> <p><i>Evidenca 2.1.Plani mësimor i programit të studimit</i> <i>Evidenca nr.30.Aneks tabelash; Tabela nr.9</i></p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale e specialitetesh, jep njohuri të përparuara në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuara në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>Duke shqyrtuar programin mësimor si dhe përmbajtjen e syllabuseve konstatohet që arrihet të transmetohen njohuri të fushës së financës, bankës, sigurimeve dhe pasurisë së paluajtshme dhe deri diku menaxhimit në këto fusha. Kjo bën të mundur që studentët që përfundojnë këtë program mund të punësohen si specialistë në finance banke, institucione të sigurimeve dhe në vlerësim pasurie si dhe të mund të vazhdojnë programin e ciklit të dytë në profilet e këtij programi pas diplomimit të tyre.</p> <p>Plani mësimor është i qartë dhe në të janë të paraqitura lëndët/ modulet me gjithë ngarkesën e tyre në mënyrë që të përmbushen më mirë objektivat e mesimnxenies nga ana e studentëve do të sugjerohet disa rregullime kryesisht teknike që nuk prekin përmbajtjen e programit të propozuar. Kështu:</p> <ol style="list-style-type: none"> a. <i>Ne vitin e parë lënda “Metodat e kërkimit dhe shkrimi akademik” mund të përshtatej në “ Shkrimi akademik dhe komunikimi në biznes “. Kjo do ta lehtësonte studentin e kursit të parë me njohuritë rreth kërkimit shkencor që mund ti marre edhe në ciklin e dytë.</i> b. <i>Meqë programi i studimit përfshin katër drejtime kryesore do ishte mire që studentin në vitin e tretë të kishte mundësi alternative të lendeve me zgjedhje. Kjo do të përmbushte me mire edhe preferencat e tyre në tregun e punës në drejtimet finance, banke sigurime apo pasuri të paluajtshme.</i> <p><i>Evidenca 2.1.Plani mësimor i programit të studimit</i> <i>Evidenca nr.30.Aneks tabelash; Tabela nr.9</i></p>
<p>Kriteri 3. Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke</p>	<p>Mbështetur në pasqyrën e hartuar nga institucioni “Plani mësimor i ndare sipas veprimtarive formuese” evidentojmë se organizimi i kurrikulës</p>

<p>grupuar lëndët/ modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.</p>	<p>respekton kriteret e përcaktuara në VKM nr 41, date 25.01.2018 sipas tipit të veprimtarisë nga A tek E si më poshtë: Lëndët e kategorisë A zënë 20 % të numrit të krediteve; Lëndët e kategorisë B zënë 55 %; të numrit të krediteve; Lëndët e kategorisë C zënë 13.3. %; të numrit të krediteve; Lëndët e kategorisë D zënë 8.9 %; të numrit të krediteve; Lëndët e kategorisë E zënë 2.8 %; të numrit të krediteve; Bazuar në kriteret e miratuara për një program MSH shohim se struktura e programit përmbush kriteret e vendosura. <i>Evidenca 2.1.Plani mësimor i programit të studimit</i> <i>Evidenca nr.30.Aneks tabelash; Tabela nr.9</i></p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>Programi i studimit është mbështetur në plotësimin e kërkesave ligjore dhe nënligjore përfshin si komponent me vehte praktiken profesionale e cila zhvillohet menjëherë pas përfundimit të procesit mësimor dhe përpara diplomimit të studenteve. Praktika profesionale në planin mësimor është e planifikuar me 90 ore totale dhe me 4 kredite (sistemi ETCS) <i>Evidenca 2.1.Plani mësimor i programit të studimit</i> <i>Evidenca nr.30.Aneks tabelash; Tabela nr.9</i></p>
<p>Kriteri 5. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara me udhëzim të ministrisë përgjegjëse për arsimin.</p>	<p>Institucioni mbështetur në kërkesat dhe kriteret ligjore dhe nënligjore në fuqi ka hartuar “Manualin për Rekrutimin, Aplikimin, regjistrimin dhe transferimin e studenteve në UB. Në këtë dokument në kapitullin II dhe III janë të përcaktuara procedurat dhe fazat e procesit të pranimit dhe financimit të studenteve. Në këtë program nuk ka pasur praktike pranimi dhe financimi të studenteve me status të veçante. <i>Evidenca nr.18. “Manualin për Rekrutimin, Aplikimin, regjistrimin dhe transferimin e studenteve në UB</i></p>
<p>Kriteri 6. Programet e studimit Bachelor, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, cikël si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.</p>	<p>UB ofron vetëm këtë program studimi në Bachelor në FBSPP. Nga informacioni që GVJ ka nuk na rezulton ndonjë program Bachelor me këtë emërtim në institucionet e tjera të arsimit të lartë në Shqipëri. Përmbajtja e programit duke marrë për bazë fushën e financës në kuadër të gjere përmban në pjesën me të madhe lende që zhvillohen në programe të ngjashme Bachelor brenda dhe jashtë vendit.</p>
<p>Kriteri 7. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.</p>	<p>Programi është në proces kodifikimi në kuadër të zbatimit të VKM nr.310 date 11.05.2022” Për specifikimet dhe përmbajtjen e kodifikimit të programeve të studimit”, si dhe udhëzimit në funksion të këtij vendimi nr.31.datë 15.11.2022. <i>Referuar takimeve në Institucion</i></p>
<p>Kriteri 8. Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në</p>	<p>Programi Bachelor në FBSPP, aktualisht nuk është një program i përbashkët me ndonjë institucion tjetër të arsimit të lartë vendas apo të huaj.</p>



përputhje me legjislacionin në fuqi.									
Konkluzione	<i>GVJ bazuar në dokumentacionin e ofruar nga institucioni si dhe vizitën e realizuar në institucion konkludon se program i studimit Bachelor në FBSP organizohet në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi në strukturë dhe përmbajtje. Megjithatë në funksion të përmirësimit të tij dy sugjerimet e GVJ në kriterin nr.2 të këtij standardi do i shërbenin këtij procesi.</i>								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <tr> <td>Nuk përmbushet</td> <td>Përmbushet pjesërisht</td> <td>Përmbushet kryesisht</td> <td>Përmbushet plotësisht</td> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Standardi II.2	
Njësia kryesore/ bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/ bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.	<p>FEQD si njësia kryesore e këtij program studimi përmbush detyrimet ligjore në organizim, strukturë dhe staf akademik. Kjo njësi përbehet nga tre Departamente që në total për vitin akademik 2021-2022 përfshijnë angazhimin e 32 anëtarë stafi si Personeli Akademik Efektiv (PAK).</p> <p>DESF si njësi baze që mbulon këtë program studimi i plotëson kriteret ligjore të përcaktuara.</p> <p>Në vitin akademik 2020-2021 DESF kishte në përbërjen e tij 10 PAE dhe 16 PAK</p> <p>Në vitin akademik 2021 -2022 kjo njësi ka në përbërjen e tij 13 PAE nga te cilët 2 anëtarë janë me titullin akademik Profesor, 4 anëtarë me gradën shkencore Doktor dhe 8 anëtarë janë me MSc. Departamenti ka të angazhuar si Personel Akademik me Kontrate (PAK) 20 pedagogë.</p> <p>Në vitin akademik aktual 2022- 2023 kjo njësi ka 13 PAE nga te cilët 3 anëtarë janë me titullin akademik profesor, 5 anëtarë janë me gradën shkencore Doktor dhe 5 anëtarë janë me MSc. Departamenti ka të angazhuar si Personel Akademik me Kontrate (PAK) 13 pedagogë.</p> <p><i>Evidence nr.30. Aneks tabelash ; Tabela nr.1dhe 2</i></p>
Kriteri 2. Njësia kryesore/ bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik/ administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.	Nuk ka të dhëna
Kriteri 3. Njësia kryesore/ bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinorit të programit të studimit, i cili është	<p>Nuk ka koordinator për programin por me urdhër të Rektorit caktohet koordinator i departamentit i cili asiston përgjegjësin e departamentit në mbikëqyrjen e ecurisë së programit të studimit.</p> <p><i>Rekomandojmë që në rregulloren e programit të sanksionohet edhe koordinatori përkatës, ose të miratohet me vendim të Dekanit koordinatori</i></p>

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 22-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 12

përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.	për programin. Kjo është e rëndësishme për faktin që numri i studenteve të regjistruar në këtë program studimi është shumë i ulët. Koordinatori i programit do të marrë kështu me shumë përgjegjësi për ecurinë e programit dhe rritjen e numrit të studenteve potencial të regjistruar në program.		
Konkluzione	GVJ bazuar në dokumentacionin e ofruar nga institucioni si dhe vizitën e realizuar në institucion konkludon se njësia kryesore FEQS dhe njësia baze DESF të program të studimit Bachelor në FBSP plotësojnë kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë. Mendojmë se përfshirja në stafin e DESF e një punonjësi si personel ndihmës akademik si dhe caktimi i një koordinatori të vete programit të studimit do të mbështesnin me mire ecurinë e programit.		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X	

Standardi II.3	
Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të parë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/ bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit të prezantuar nga FEQD dhe DESF dhe nga verifikimi gjatë vizitës në institucion, rezultoi se këto njësi disponojnë informacionin e nevojshëm mbi organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit dhe jo vetëm si evidencë, por dhe janë të aksesueshme nga gjithë stafi akademik. Ky informacion përfshin të dhëna të plota të programit si dhe gjithë bazën rregullative në nivel institucioni, fakulteti, departamenti dhe programi.
Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore të lëndëve/ moduleve, orët në auditor/ jashtë auditorit.	Nga shqyrtimi i programit të studimit vërejmë se ai jep të gjithë informacionin e nevojshëm me elementet përkatës të tij si ngarkesën mësimore, orët në auditor dhe jashtë tij, ndjekjen e programit (me kohë të plotë) si dhe vlerësimin e dijeve. Në mbështetje të programit janë edhe rregulloret përkatëse në nivel institucioni fakulteti departamenti si dhe të vete programit. Po ashtu në rregullore të veçanta jepen modalitetet dhe kriteret e regjistrimit të studenteve potencial në këtë program si dhe transferimet nga jashtë apo brenda të studimeve në këtë program. <i>Evidenca 2.1. Plani mësimor i programit të studimit</i> <i>Evidenca nr. 3. Rregullore e programit të studimit</i>
Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.	Institucioni bazuar në kuadrin ligjor dhe nënligjor ka hartuar bazën rregullatore lidhur me procesin përcaktimit të kriterëve të përgjithshme apo specifike lidhur me pranimin, transferimin dhe ekuivalentimin e studimeve apo studenteve. Gjate vizitës në institucion pranë zyrës së sekretarisë mësimore GVJ evidentoi për vitin akademik 2020-2021 1 rast transferimi student i bazuar në procedurat e miratuara. <i>Evidenca nr. 18. Manual për rekrutimin, Aplikimin, Regjistrimin dhe transferimin e studenteve në UB</i> <i>Evidenca nr. 3 Rregullore e Programit të Studimit.</i>



	<i>Evidence nr. 19.1. Rregullore e brendshme e transferimit dhe regjistrimit.</i>			
Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikant, seminarin apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.	<p>Nga shqyrtimi i programit të studimit rezulton se ai përfshin gjithë elementët përbërës formues teorik praktik për një program të nivelit Bachelor. Nga shqyrtimi i syllabuseve vërehet se ato hartohen në gjuhë shqipe dhe përmbajnë të gjithë elementët e përcaktuara në Vendimin e KM Nr.41, datë 24.01.2018, i ndryshuar, si :</p> <ul style="list-style-type: none"> • Emërtimi i lëndës/ modulit • Viti/ semestri kur zhvillohet lënda • Emri i pedagogut që do të zhvillojë lëndën • Vendi që zë lënda në forumin tërësor të studentit • Njohuritë paraprake që duhet të ketë studenti për përvetimin e lëndës • Çfarë njohurish dhe aftësish i jep studentit kjo lëndë • Temat që do të trajtojnë lënda në formimin teorik dhe praktik • Ngarkesa në orë në auditor dhe jashtë auditorit si dhe në ECTS • Format dhe metodat e mësimdhënies të lëndës dhe raportet midis tyre • Format e vlerësimit të studentëve • Detyrimet e studentit për lëndën • Literatura e detyruar dhe ajo ndihmëse <p>GVJ vlerësoi cilësinë e syllabuseve të programit të prezantuar në kuadër të këtij vlerësimi. Hartimi i syllabuseve të programit përfshin të gjitha elementët e nevojshëm duke plotësuar kriteret për to. Nga verifikimi i dokumentacionit dhe vizita në institucion rezulton kontrolli periodik i njohurive të marra me anë të testeve apo provimit përfundimtar. Format e mësimdhënies janë nëpërmjet vlerësimit periodik në seminare (për pjesëmarrje aktive), detyra kurse, provime të ndërmjetme dhe provim final. Përkatësisht, studenti vlerësohet gjatë vitit deri në 40-50 % (detyra kurse dhe provim i ndërmjetëm) dhe 50 -60 % në provimin përfundimtar.</p> <p><i>Evidence nr.2.2.Programet lëndore të programit</i></p>			
Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.	<p>Nga takimi me stafin akademik që mbulon këtë program si dhe me stafin e DESF u evidentua diskutimi dhe axhustimi i programit në mënyrë periodike në fillim të vitit brenda lirisë akademike si dhe futjen e informacioneve të reja të njohurive përkatës.</p> <p><i>Diskutime nga takimi me stafin gjatë vizitës në institucion</i></p>			
Konkluzione	<p><i>GVJ bazuar në dokumentacionin e ofruar nga institucioni si dhe vizitën e realizuar në institucion konkludon se programi i studimit Bachelor në FBSP është i detajuar me të gjithë elementet përkatës, si dhe i strukturuar dhe organizuar për të plotësuar objektivat formues të tij. Përmbajtja e lendeve /moduleve të programit janë jo vetëm në formë me të gjithë elementet përkatës por edhe në përmbajtjen e tyre.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.4	
Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit dhe vazhdimin të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ ose punësimin e studentëve.	Programi në emërtim dhe përmbajtjen e tij ofron tiparet e një program studimi të nivelit Bachelor në fushën e financës, bankës, sigurimeve dhe pasurive të paluajtshme. Programi synon të kombinojë njohuritë teorike në këtë fushë me ato praktike. Këtë e shikojmë në përmbajtjen e lëndëve të programit si dhe në realizimin e praktikës profesionale me mundësi punësimi në treg. Emërtimi dhe përmbajtja jo vetëm u mundëson punësimin në përfundim të studimeve në finance, banka, sigurime dhe vlerësim pasurie port e diplomuarit në këtë program mund të vazhdojnë ciklin e dyte të studimeve në një spektër me të gjere të financës. <i>Evidenca 2.1.Plani mësimor i programit të studimit</i> <i>Evidence nr. 3.Rregullore e programit të studimit</i>
Kriteri 2. Lëndët/ modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit.	Programi arrin të pajisë studentët me kompetenca të përgjithshme në të katër drejtimet e tij. Duke analizuar programin shohim që studentet në vitin e pare marrin njohuritë baze makro dhe mikroekonomike, matematike, statistike dhe konceptet në financë të domosdoshme për çdo program të fushës se ekonomisë. Në vitin dyte në disa nga lendet që zhvillohen merren njohuri të menaxhimit por edhe të fushave baze të sigurimeve pasurive të paluajtshme etj. në vitin e trete programi ofron njohuri me specifike lidhur me financën, bankave, pasuritë e paluajtshme et të cilat krahas praktikës profesionale finalizohen me detyrimet përmbyllëse. Mbështetur në lëndët që ofron programi, por edhe në praktikën profesionale të përfshirë në të, ai arrin të ketë objektiv formimin teorik shkencor dhe relativisht edhe atë aplikativ të studentëve. <i>Evidenca 2.1.Plani mësimor i programit të studimit</i> <i>Evidence nr. 3.Rregullore e programit të studimit</i>
Kriteri 3. Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.	Programi në hartimin dhe zhvillimin e tij bazohet në eksperiencat bashkëkohore Europiane dhe të vendit, si edhe duke vlerësuar nevojat e tregut të punës. Mbështetur në strukturën e programit, në lëndët që përfshihen në të, raportet teorike praktike, ky program përputhet me fushën e zgjedhur që është ajo financiare e bankar. Në të arrihet të trajtohen elementët e nevojshëm që lehtësojnë njohjen dhe ekuivalentimin e diplomës jashtë vendit, për qëllim vazhdimin e studimeve në ciklin e dyte apo punësimin e studentit. Programi i studimit është në përputhje me objektivat e përcaktuara në legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara. <i>Evidenca 2.1.Plani mësimor i programit të studimit</i> <i>Evidence nr. 3.Rregullore e programit të studimit</i>
Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e	Përmbajtja e programit të studimit harmonizon përmbajtjen teorike me atë praktike. Nga shqyrtimi i syllabusve të lendeve karakterizuese të programit shohim që në to nja pjese të temave u referohen rasteve studimore apo praktikave laboratorike. Përmbajtja e tyre është e bazuar në përmbajtjen e


objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.	lendeve të tilla edhe në universitetet e huaja duke mundësuar ekuivalentimin në rast transferim studimi <i>Evidenca 2.1.Plani mësimor i programit të studimit</i> <i>Evidenca nr. 3.Rregullore e programit të studimit</i>								
Kriteri 5. Syllabuset (programet e lëndëve/ moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.	Nga shqyrtimi i përmbajtjes të lendeve të këtij program të prezantuar nga institucione vërejmë se në pjesën me të madhe të tyre ka përditësim të njohurive bazuar në literature detyruese dhe ndihmëse të botuar gjate viteve të fundit. Edhe nga takimi me stafin e DESF gjate vizitës në institucion në evidencuam përditësimin e literaturës. Megjithatë në disa nga programet e lendeve ka nevojë që literatura e rekomanduar të jete e viteve të fundit. <i>Evidenca 2.2. Përmbajtja e lendeve të programit të studimit</i> <i>Evidenca nr. 3.Rregullore e programit të studimit</i>								
Kriteri 6. Përmbajtja e programit të studimit garanton përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.	Përmbajtja e programeve realizon përfitimet e dijeve dhe aftësive të studenteve për një program bachelor në FBSPP. Programi i studimit përfshin trajtimin fillimisht të lendeve baze me formim mikro dhe makroekonomik dhe që në vitin e parë përfshihen lendet e përgjithshme në fushën e financës dhe kontabilitetit për tu pasuar në vitet e tjera me lende kryesisht profesionale në fushën e programit. Programi i studimit kombinon si trajtimin teorik ashtu edhe atë aplikativ sidomos në lendet e menaxhimit. <i>Evidenca 2.1.Plani mësimor i programit të studimit</i> <i>Evidenca nr. 3.Rregullore e programit të studimit</i>								
Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.	Programi i studimit është mbështetur në eksperiencën e programeve të tilla kombëtare, por edhe në ato ndërkombëtare. Përmbajtja e programit është e tilla që nëpërmjet njohurive të marra në të katër drejtime e ti të beje të mundur për studentet e diplomuar vazhdimin e studimeve në ciklin e dyte të programit Master. Gjithashtu, ky program u mundëson hyrjen në tregun e punës të studentëve në katër drejtimet e tij. Specifikimi që në emërtim i këtyre katër drejtimeve është përparësi në mundësinë e punësimin të te diplomuarve dhe kjo sidomos në tregun imobilar. <i>Evidenca 2.1.Plani mësimor i programit të studimit</i> <i>Evidenca nr. 3.Rregullore e programit të studimit</i>								
Konkluzione	<i>GVJ bazuar në dokumentacionin e ofruar nga institucioni si dhe vizitën e realizuar në institucion konkludon se program i studimit Bachelor në FBSP përmbush objektivat formuese të tij dhe nivelin kualifikues sipas Kuadrit Kombëtar dhe European të Kualifikimeve duke mundësuar studentet e diplomuar për tu punësuar në tregun financiar dhe me gjerë.</i>								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Niveli i përmbushjes</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Niveli i përmbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Niveli i përmbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Standardi II.5

Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.


Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
<p>Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.</p>	<p>DESF si njësi baze dhe përgjegjëse e këtij program bazuar në marrëveshjet institucionale me aktoret e tregut të punës bën përpjekje në përmirësimin e programeve ku ajo është përgjegjëse drejtpërdrejt. Lidhur me këtë program i cili ka vetëm tre vite akademike që zhvillohet, përmirësimet në program kane qene kryesisht në kuadrin e lirisë akademike të stafit. Nga diskutimi me stafin akademik që zhvillon këtë program evidentuam përmirësim në ciklet e leksioneve të lendeve që ata mbulojnë kryesisht me trajtime aplikative të lidhura me tregun financiar dhe pasuritë e paluajtshme .</p> <p><i>Evidence nr.4. Studim tregu për programin Bachelor në FBSPP</i> <i>Evidence nr 22. Marrëveshje bashkëpunimi të UB</i> <i>Evidence nr. 22.1. 22.1. Model marrëveshje bashkëpunimi me Deloitte Albania.</i> <i>Vizita në institucion dhe takim me stafin akademik</i></p>			
<p>Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.</p>	<p>Diskutimi dhe opinion i studenteve rreth programit mësimor dhe mësimdhënies realizohet nëpërmjet diskutimeve me pedagogun e lendes por edhe nëpërmjet instrumentit të vlerësimit nëpërmjet anketimeve që ruajnë anomantetin e tyre që ata bëjnë për lenden dhe pedagogun përkatës. Institucioni mban kontakte me studentet e diplomuar ku Zyra e Karrierës dhe Alumni përgjegjëse për këtë lidhje kontaktojnë me të diplomuarit. Numri i vogël i të diplomuarve deri tani në këtë program është vetëm 4 studente.</p> <p><i>Evidence nr.11.8. Instrumente vlerësimi nga studentet</i> <i>Evidence 11.8.1 dhe 2: Raport mbi rezultat e formularit të studentit 2021-2022 Sem i dhe II</i></p>			
<p>Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra profesionale (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.</p>	<p>Ky program studimi u parapri nga një studim tregu pune duke ndikuar që program të këtë emërtim dhe përmbajtje për secilën drejtim të tij (katër të tilla).</p> <p>DESF ndjek dhe zhvillimet e fundit në këtë treg pune dhe koordinon bashkëpunimin me aktoret e këtij tregu nëpërmjet marrëveshjeve të lidhura.</p> <p><i>Evidence 3. Rregullore e programit të studimit</i> <i>Evidence nr.4. Studim tregu pune për programin Bachelor FBSPP.</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ bazuar në dokumentacionin e ofruar nga institucioni si dhe vizitën e realizuar në institucion konkludon se përfshirja e studenteve në procesin e përmirësimit dhe vlerësimit të programit plotëson standardet e kërkuara duke qene premise në përmirësimin e tij në të ardhmen..</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X
<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X



III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit, aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/ esetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>	<p>Mësimdhënia në programin Bachelor në “FBSPP” bazohet në rregulloren mësimore në nivel institucional dhe rregulloren e FEQD të cilat përcakton format e mësimdhënies dhe vlerësimin e dijeve të studentëve. Procesi mësimor zhvillohet nëpërmjet formave të mirënjohura: leksione, seminare, detyra kursi, ushtrime, praktika profesionale etj, të organizuara në 29 lëndë, ku janë parashikuar teste të ndërmjetme, Detyra kursi, provim përfundimtar dhe tema e diplomës. të gjitha lëndet klasifikohen vetëm si lëndë të detyruara. Në planin mësimor orët mësimore në auditor dhe jashtë auditorit si angazhim individual i studentit janë të përcaktuar sipas të gjitha elementeve të një programi të nivelit Bachelor. Në këtë program lëndët zhvillohen sipas syllabusit përkatës dhe në liri të plotë të personelit akademik. Për të ruajtur objektivitetin e vlerësimit forma e kontrollit në program është me shkrim dhe e sekretuar. Në politikën e Institucionit është praktikë që nota e studentit të jetë e “ndërtuar”, që do të thotë që studentit testohet gjatë semestrit në secilën lëndë përveç provimit përfundimtar në sezon. Shumatorja e pikëve të mbledhura përbën vlerësimin e tij përfundimtar. Forma e vlerësimit referuar ECTS përcaktohen me notë (1 deri 10) dhe ekuivalentin e notave nga F në A. Ky sistem vlerësimi përfshin 100 pikë, të cilat përgjithësisht janë të ndara në:</p> <ul style="list-style-type: none"> • 10 % frekuentimi dhe vlerësimi gjatë semestrit; • 30 % testi i ndërmjetëm apo detyra e kursit që zhvillohet në mes të semestrit; • 60% provimi përfundimtar që zhvillohet në fund të semestrit. <p>Mënyra e vlerësimit të studentëve është e prezantuar në syllabusin e çdo lënde. <i>Evidenca 2.1. Plani mësimor i programit të studimit</i></p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.</p>	<p>Personeli akademik që mbulon këtë program ka aftësitë pedagogjike bashkëkohore në mësimdhënie rrjedhë kjo edhe e eksperiencës relativisht të gjatë në procesin e mësimdhënies. Nga ana tjetër, nga takimi me studentët e këtij programi, GVJ evidentoi faktin e marrjes se mendimit të studenteve lidhur me përmirësimin e procesit të mësimdhënies për të kryer më shumë seanca seminarë praktike të mësimnxënies nga studentët. <i>Vizita në institucion dhe takimi me stafin dhe studentet e programit.</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit.</p>	<p>Bazuar në takimin me stafin e DESF rezultoi se UB mbështet stafin akademik në përmirësimin e metodës pedagogjike kryesisht nëpërmjet vizitave pranë universiteteve homologe të huaja, si dhe mobiliteteve në kuadër të projektit ERASMUS+. <i>GVJ nuk evidentoi mbështetje didaktike në formën e takimeve me eksperte të fushës apo trajnime të strukturuar në nivel universiteti dhe Fakulteti me ekspertë të fushës së pedagogjisë. Evidencë 10.1. të dhëna mbi marrëveshjet e bashkëpunimit mobilitete dhe ERASMUS + në UB. Takimet e organizuara gjatë vizitës në institucion.</i></p>

<p>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit të student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>Personeli akademik që mbulon këtë program ka eksperiencën dhe kualifikimin e duhur për një proces mësimdhënie të suksesshëm. Bazuar në CV-të e stafit akademik, vëmë re që pothuajse të gjithë kanë një formim akademik dhe profesional në fushën e Financës dhe lëndëve që karakterizojnë drejtimet përkatëse. Nga takimi me studentët e programit u evidentua një bashkëpunim reciprok i frytshëm mes tyre dhe personelit akademik. Numri i ulet i studenteve që zhvillojnë këtë program e bën komod për ta krijimin e marrëdhënieve të bashkëpunimit si dhe mbështetjen dhe monitorimin e tyre gjate zhvillimit të programit.</p> <p><i>Evidenca 2.1. Plani mësimor i programit të studimit Takimet e organizuara gjate vizitës në institucion.</i></p>
<p>Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e këshillat e tyre.</p>	<p>DESF gjatë viteve të fundit ka ardhur duke u konsoliduar në funksion të zhvillimit me sukses të këtij program studimi dhe cilësisë së mësimdhënies. Në këtë poçes një rol të rëndësishëm kanë studentet nëpërmjet përfshirjes se tyre në vlerësimin e mësimdhënies dhe stafit akademik në dokumentet shtese që GVJ kërkoi gjate vizitës në institucion, ky i fundit plotësoj dokumentacionin me dy raportet e vlerësimit të studenteve në vitin akademik 2021-2022 për secilin semestër. Raporti evidenton vlerësimin për gjithë studentet e institucionit dhe përfshin vlerësimin për lëndën dhe vlerësimin për pedagogun. Për këtë program studimi në raportin e semestrit të parë nga 20 studentë që e ndjekin u përgjigjen vetëm 3 prej tyre ose 15% ndërsa në semestrin e dyte janë përgjigjur 5 studentë apo 25% e tyre. Kjo praktikë vlerësimi nëpërmjet anketimit është mjaft pozitive. <i>Gjithsesi numri i ulët i studenteve të këtij program që u janë përgjigjur pyetjeve të anketës duhet konsideruar i pamjaftueshëm për të marrë një opinion me të plotë.</i></p> <p><i>Evidence nr.11.8. Instrumente vlerësimi Evidence shtese. Raport i vlerësimit të studenteve për lëndet e semestrit të pare dhe të dyte të vitit akademik 2020-2021</i></p>
<p>Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/ bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të</p>	<p>UB krahas akteve rregullatore në funksion të procesit mësimor shkencor (Manuali i mësimdhënies) ka miratuar Komisionin e Sigurimit të Standardeve të Cilësisë (KSSC) si njësi përgjegjëse në nivel institucional që promovon përmirësimin e mësimdhënies në kuadër të përmirësimit të cilësisë. Me vendim të Senatit të UB Nr.63, date 13.04.2021 është miratuar edhe rregullorja e funksionimit të KSSC-se ku sanksionohen funksionet dhe mënyra e operimit të kësaj njësie. Gjithashtu në nivel institucional funksionon edhe Njësia e Zhvillimit të Kurrikulave dhe Cilësisë (NJZHKC). Me vendim të Senatit nr. 58. Date 10.03.2021 është miratuar edhe rregullorja e NJZHKC. Institucioni ka miratuar në mbledhjen e Senatit të datës 10.03.2021 rregulloren për vlerësimin dhe administrimin performanes. Në këtë dokument struktura kompetente për vlerësimin e performances është Komisioni i Vlerësimit të Performances (KVP) që bazuar në nenin 5 të rregullores zhvillon dy procese kryesore vlerësimi;</p>



mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.	<p>Vlerësimin e performances se personelit si dhe vlerësimin e proceseve institucionale (vlerësim i procesit akademik).</p> <p>Strukturat/ njësitë e ngritura në nivel institucional kane një historik të shkurtër dhe si rrjedhojë kane realizuar vetëm vlerësimin me anën e anketimeve të studenteve. <i>GVJ nuk evidentoi forma të tjera të angazhimit dhe realizimit të këtyre njërive në eksperimentimin dhe zhvillimin e trajnimeve të trajnimeve për metoda të reja mësimdhënie.</i></p> <p><i>Evidence nr.30. Rregullore e KSSC</i></p> <p><i>Evidence nr.10. Rregullore e NJZHKC</i></p> <p><i>Evidence nr.12.Rregullore për vlerësimin dhe administrimin e performances</i></p>			
Konkluzione	<p><i>GVJ bazuar në dokumentacionin e ofruar nga institucioni si dhe vizitën e realizuar në institucion konkludon se UB realizon në procesin e mësimor gjithë elementet e duhur të ndara në leksione ,seminare ,projekte e detyra kursi, praktike profesionale etj. Institucioni në përmbushje të akteve ligjore dhe nënligjore ka ngritur strukturat përkatëse që promovojnë vlerësojnë dhe mbikëqyrin përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies. Eksperienca e shkurtër e ngritjes se këtyre njërive /strukturave në nivel institucional ka mundur të realizojë vlerësimin nga studentet të procesit mësimor dhe stafit akademik. Gjate kësaj periudhe GVJ nuk evidentoj realizim të formave të tjera për rritjen e cilësisë të mësimdhënies nëpërmjet trajnimeve të stafit në aspektin didaktik dhe pedagogjik me qellim zhvillimin e metodave të reja dhe bashkëkohore të mësimdhënies.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	


Standardi III.2	
Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/ Rregulloren e Institucionit/ rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	<p>Kriteret dhe mënyra e testimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale janë të përcaktuara qartë në rregulloret e posaçme, të cilat janë pjesë zbatuese si në nivelin institucional ashtu edhe për programin e studimit. në rregulloren e UB janë të përcaktuara parimet dhe kriteret kryesore të vlerësimit të dije. Kështu në nenin nr.85 të Rregullores se UB, përcaktohet se “vlerësimi i dijeve dhe aftësive profesionale bazohet në parimin e kontrollit të vazhdueshëm”. Me të detajuara kriteret dhe mënyra e vlerësimit të njohurive përcaktohen në rregulloren e këtij programi studimi si dhe në programin e çdo lende (syllabusin) në pjesën e vlerësimit. Këto dokument janë aksesueshme si nga stafi akademik edhe nga studentet.</p> <p><i>Evidence nr 2, Rregullore e UB</i></p> <p><i>Evidence nr.3.Rregullorja e programit Bahelor në FBSPP</i></p>
Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/ moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e	<p>Bazuar në dokumentacionin e ofruar dhe vizitën në institucion, GVJ evidenton se studentët e programit informohen mbi mënyrën e vlerësimit të njohurive nëpërmjet:</p>

<p>vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/ moduleve nga titullari i lëndës/ modulit.</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Informacionit të marrë në webin e institucionit pasi rregulloret në këtë drejtim janë të përfshira në te. • Informacionit që marrin që në fillim të semestrit përkatës nëpërmjet syllabuseve të lëndëve përkatëse të pedagogëve përgjegjës për zhvillimin e tyre. <p>Pedagogu i lëndes në fillim të zhvillimit semestrit sqaron dhe informon studentet për kohën dhe elementet e vlerësimit të vazhduar dhe atë përfundimtar.</p> <p><i>Evidencë nr.2.2.Programet lëndore të programit të studimit në FBSPP Takim me stafin akademik dhe studentet e programit.</i></p>
<p>Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.</p>	<p>Vlerësimi i njohurive të studentëve realizohet në format tashmë të konsoliduar dhe përfshijnë elementë të vlerësimit të vazhdueshëm në seminar, testimin e ndërmjetëm, detyrat e kursit, provimin përfundimtar etj, elementë këto që u evidentuan gjatë shqyrtimit të programeve të lendeve si dhe takimit me stafin akademik dhe studentet e programit të studimit.</p> <p><i>(Evidencë nr.2.2.Programet lëndore të programit të studimit në FBSPP Evidence nr.3.Rregullorja e programit Bachelor në FBSPP Takim me stafin akademik dhe studentet e programit.</i></p>
<p>Kriteri 4. Njësia bazë/ Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>Mendimi i studenteve për cilësinë e mësimdhënies dhe vlerësimi i tyre për performance e pedagogut realizohet nëpërmjet organizimit nga NJZHKC të anketimit on line. Ky anketim realizohet në fund të çdo semestri. Raporti i rezultateve të dalta hartohet nga kjo njësi dhe analizohet në DESF si njësi baze e këtij program studimi. Siç edhe e kemi përmendur me lart në këtë raport pjesëmarrja e studenteve të këtij program në këtë anketim ka qenë relativisht i ulët.</p> <p><i>Evidenca 11.8. Instrumentet e vlerësimit Raporti i vlerësimit të studenteve Semestër i dhe II 2021-2022 Takimi me stafin dhe studentet</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënësve, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>Nga takimi me stafin akademik dhe studentet e programit u evidentua që realizimi i procesit mësimor nëpërmjet metodave të mirënjohura kombinohet me një qasje interactive mes tyre duke nxitur diskutimet në grupin e tyre. Kjo realizohet edhe gjatë prezantimit të detyrave të kursit duke krijuar një ambient bashkëpunues.</p> <p>Grupi i studenteve në takim vlerësonte maksimalisht formën e diskutimit me grupin e tyre gjatë zhvillimit të mësimin. Numri i vogël i studenteve në kurs është edhe një faktor që ka nxitur këtë marrëdhënie interactive mes pedagogut dhe studentit.</p> <p><i>Evidencë nr.21. Plani mësimor i programit Takimi me stafin akademik dhe studentet e programit</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ bazuar në dokumentacionin e ofruar nga institucioni si dhe vizitën e realizuar në institucion konkludon se ky i fundit ka të plotë kuadrin rregullator ,mbikëqyrës dhe procedural të vlerësimit të dije të studenteve gjatë procesit mësimor.</i></p>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Niveli i përmbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.3	
Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/ moduleve nga titullari i lëndës/ modulit.</p>	<p>Vlerësimi i njohurive të studentëve bazohet në praktikat më të mira të përdorura në IAL. GVJ, gjatë vizitës në sekretarinë mësimore, evidentoi praktika të këtij programi, në disa nga lëndët për të cilat ishte përmbyllur vlerësimi. Njohuritë e marra gjatë zhvillimit të këtyre lëndëve vlerësohen me 40% deri 50% të notës përfundimtare (angazhim në seminar, provimi i ndërmjetëm dhe detyra e kursit), ndërsa provimi përfundimtar zë 50 % deri 60% të vlerësimit, duke reflektuar kështu edhe përcaktimin e këtij vlerësimi sipas syllabusit. Mendojmë se kjo metodë vlerësimi i jep mundësi studentit të angazhohet gjatë gjithë semestrit dhe siguron një vlerësim më objektiv të angazhimit të tij në auditor dhe jashtë tij.</p> <p><i>(Evidencë nr.2.2.Programet lëndore të programit të studimit në FBSPP Evidence nr.3.Rregullorja e programit Bahelor në FBSPP</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	<p>Mënyra e testimit dhe vlerësimit të njohurive të studentëve përcaktohen në rregulloret përkatëse në nivel institucioni, njësie kryesore dhe njësie bazë. Për të gjitha lëndët e programit realizohet testimi dhe vlerësimi me shkrim. GVJ evidentoi një praktikë të tillë ku u pa që ruhej sekreti dhe konfidencialiteti i testit si dhe bëhej sekretimi përkatës i tezës dhe zgjidhjes së studentit. Vitet e fundit UB parashikon edhe të përdorë zbatimin e testimit online si një sistemi i ri i vlerësimit elektronik “clean scoring”. Mendojmë që në kuadrin rregullator të institucionit dhe rregulloren e programit të evidentohet edhe ky lloj vlerësimi dijesh.</p> <p><i>Evidencë nr.2.2,Programet lëndore të programit të studimit në FBSPP Evidence nr.3.Rregullorja e programit Bahelor në FBSPP</i></p>
<p>Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.</p>	<p>Bazuar në rregulloren e UB, e në rregulloren e këtij program dhe programet e lendeve, GVJ evidentoi praktike vlerësimi të studenteve ku konfirmohet se vlerësimi përfundimtar reflekton zbatimin e këtyre akteve rregullative. Vlerësimi përfundimtar i bazuar në pike reflektohet në notën përkatëse që është i detyrueshëm dhe automatikisht edhe me germa (sistemi ETCS) nga A deri F.</p> <p><i>Evidence nr.3.Rregullorja e programit Bahelor në FBSPP Evidence nr.13.Rregullore për testimin e provimeve , kriteret dhe procedurat e diplomimit.</i></p>
<p>Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/ feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënit për të ndihmuar</p>	<p>Vlerësimi me 40% dhe në disa lende deri 50% të pikëve të dijeve gjatë vitit jo vetëm i “mban të angazhuar” vazhdimisht studentët, por u mundëson të diskutojnë dhe të këshillohen me pedagogët përkatës për të përmirësuar mësimnxënien e tyre sidomos kjo për detyrat e kursit të cilat në shumicën e lëndëve karakterizuese janë edhe aplikative. GVJ evidentoi formatin e disa testeve dhe konstatoi që format e pyetjeve dhe ushtrimeve praktike</p>

<p>studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>përmbajnë elementë standard të vlerësimit: pyetje me alternativa, pyetje me koment, ushtrime etj <i>Evidencë nr.2.2.Programet lëndore të studimit në FBSPP</i> <i>Evidencë nr.3.Rregullorja e programit Bahelor në FBSPP</i> <i>Evidencë nr.13.Rregullore për testimin e provimeve , kriteret dhe procedurat e diplomimit.</i></p>			
<p>Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/ nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.</p>	<p>Bazuar në kuadrin rregullator në nivel institucional dhe të njësisë bazë, DESF monitoron zhvillimin normal të testimit duke u përpjekur që ai të jetë realist dhe vlerësimi të jetë meritë e angazhimit të studentëve me njohuritë e kërkuara duke eliminuar sa më shumë format e kopjimit apo të abuzimit në këtë drejtim në rregulloren përkatëse evidentohen edhe mjaft detaje në funksion të realizimit të provimit sa me serioz. <i>Evidencë nr.3.Rregullorja e programit Bahelor në FBSPP</i> <i>Evidencë nr.13.Rregullore për testimin e provimeve , kriteret dhe procedurat e diplomimit.</i></p>			
<p>Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>Realizimi me korrektësi i testeve gjatë vitit akademik dhe në fund të tij është një garanci për vlerësimin e saktë të studentëve. Përgjigjet e testimit merren nga studentët brenda 5 ditëve nga zhvillimi i tij dhe ata kanë të drejtën e reklamimit të tij, siç edhe është parashikuar në rregulloren përkatëse. <i>Evidencë nr.3.Rregullorja e programit Bahelor në FBSPP</i> <i>Evidencë nr.13.Rregullore për testimin e provimeve , kriteret dhe procedurat e diplomimit.</i></p>			
<p>Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit. Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.</p>	<p>Nga takimi me studentët, GVJ evidentoi faktin se përpara se pedagogu të dërgojë procesverbalin në sekretarinë mësimore lihet një ditë reklamimi për ta nëse ndonjë ka paqartësi apo pretendime mbi vlerësimin. Ky proces është i sanksionuar edhe në rregulloren e UB dhe rregulloren e vete programit. <i>Evidencë nr.3.Rregullorja e programit Bahelor në FBSPP</i> <i>Evidencë nr.13.Rregullore për testimin e provimeve , kriteret dhe procedurat e diplomimit.</i> <i>Takimi me studentet e programit</i> Procesi i ankimit nga ana e studentit është i sanksionuar si në rregulloren e UB neni 89 dhe 90, . Praktikantët e ankimit të studentëve lidhur me vlerësimin kanë qenë të pakta në numër të evidentuara nga takimi me grupin e studenteve.. Por, në rastet e evidentuara, Departamenti ngre komision vlerësimi të posaçëm dhe procesi dokumentohet deri në fund. <i>Evidencë nr.3.Rregullorja e programit Bahelor në FBSPP</i> <i>Evidencë nr.13.Rregullore për testimin e provimeve , kriteret dhe procedurat e diplomimit.</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p>GVJ bazuar në dokumentacionin e ofruar nga institucioni si dhe vizitën e realizuar në institucion konkludon se arrihet një vlerësim i drejtë i dijeve të studenteve duke respektuar konfidencialitetin, paanësinë dhe të drejtën e ankimit nga studentet dhe zgjidhjes se saj.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht X</p>



Standardi III.4**Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.	Programi arrin të pajisë studentët me kompetenca të përgjithshme në fushën e financës, bankës tregut të sigurimeve dhe pasurisë imobilare. Programi synon që të rrisë edhe kompetencat profesionale të studentëve me fokus rritjen e aftësive praktike në këto drejtime. Mbështetur në 29 module që ofron programi, por edhe në praktikën profesionale të përfshirë në të, ai arrin të ketë objektiv formimin teorik dhe relativisht edhe atë profesional të studentëve. Në këtë kuadër praktika profesionale dhe përgatitja e diplomës që synohet të jetë aplikative, i shërbejnë këtij objektivit dhe rrisin më shumë përgatitjen profesionale të studentëve. <i>Evidenca 2.1.Plani mësimor i programit të studimit</i> <i>Evidenca nr.3.Rregullorja e programit Bahelor në FBSPP</i>
Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit.	Bazuar në programin mësimor, ky program studimi garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në katër drejtimet e tij nëpërmjet lendeve karakterizuese. Njëkohësisht gjejnë relativisht trajtime në zhvillimin e aftësive në fushën e informacionit në trajtimin e rasteve studimore në një numër lendesh të këtij programi. Më evidente aftësitë në fushën e teknologjisë dhe informacionit studentet i marrin në lëndet si “Teknologjia dhe Informacioni, e-biznesi dhe e- bankingu” etj. Gjate periudhës së pandemisë COVID-19 mësimi është realizuar përmes platformave të mirënjohura tashme si Google lassroom, sistemi Tims etj. Per mbarëvajtjen e procesit mësimor në tete periudhe institucioni hartoi dhe udhëzime dhe manuale përkatëse. <i>Evidenca 2.1.Plani mësimor i programit të studimit</i> <i>Evidenca nr.3.Rregullorja e programit Bahelor në FBSPP</i> <i>Evidenca 11.3. Manuali i përdorimit të Google classroom.</i> <i>Evidenca nr.3.Rregullorja e programit Bahelor në FBSPP</i>
Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre dhe për detyrimet përmbyllëse.	Nga takimi me stafin e programit dhe studentët, GVJ evidentoi që në orën e fundit të leksionit bashkëbisedohej mes pedagogut dhe studentit mbi realizimin e programit të lëndës bazuar në syllabusin e paraqitur që në fillim të semestrit) si dhe orientoheshin këta të fundit për provimin final. <i>(Evidentim nga vizita në institucion dhe takimi me stafin akademik dhe studentet.)</i>
Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t’u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet	Bazuar në dokumentacionit dhe takimin e zhvilluar me stafin e programit të studimit dhe studentet e këtij programi konstatohet që pedagoge të nje sere lendesh realizonin zhvillimin e programit në tema të caktuara nëpërmjet punëve laboratorike. Në me të shumtën e rasteve përgatitja dhe mbrojtja e detyrës së kursit behet laboratorin e informatikës. Grupi i vogël i studenteve në këtë program e bën të domosdoshme edhe mënyrën e diskutimit të problematikave mes studenteve dhe pedagogut të lendes. Një

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al


Tel:+355 (04) 22-43423

Web site: www.ascal.al



Faqe 24

<p>diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuarra kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.</p>	<p>rol të rëndësishëm në formimin praktik të studenteve luan edhe realizimi i praktikës profesionale e cila është mundësuar në drejtimet kryesore që ofron ky program dhe që orientohet nga paketa e praktikës për programin Bahelor.</p> <p><i>Evidence 2.3.2. Paketa e praktikës profesionale Bahelor 2021-2022</i> <i>Evidentim nga vizita në institucion dhe takimi me stafin akademik dhe studentet.)</i></p>			
<p>Kriteri 5. Personeli akademik, efektiv dhe me kontratë, realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/ jashtë strukturës së programit të studimit.</p>	<p>Institucioni në mënyrë aktive realizon aktivitete në formën e takimeve, leksioneve të hapura me pjesëmarrjen e profesionisteve të fushave përkatëse. Në rang njësie baze, ne evidentuam kalendarin e aktiviteteve të DESF ku pjesëtarë të stafit akademik parashikonin të realizonin takime trajnimi me studentet dhe profesioniste jashtë institucionit. në dokumentacionin e aplikimin prezantohet edhe raporti i aktiviteteve dhe trajnimeve profesionale që janë organizuar në institucion.</p> <p><i>Evidence 20.8. Aktivitetet dhe trinimet profesionale</i> <i>Evidence nr.33. Kalendari i aktiviteteve të DESF. 2022-2023</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ bazuar në dokumentacionin e ofruar nga institucioni si dhe vizitën e realizuar në institucion konkludon se program i studimit Bachelor në FBSP arrin të përmbushë objektivat e tij duke pajisur studentet me njohuri teorike praktike dhe me aftësi profesionale në fushën e financës, bankës, sigurimeve dhe pasurisë së paluajtshme . Përmbajtja e këtij program u jep mundësi të diplomuarve të kenë një spektër të gjer e punësimi në tregun e punës në të kater drejtime e programit.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi III.5 Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmblylëse të studentit në programin e studimit dhe e pajis atë me dokumentacionin përkatës.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni harton rregullore të posaçme për provimin i përgjithshëm përfundimtar ose punimin e diplomës. Në rregulloren e programit të studimit përcaktohet pragu i notës mesatare që i jep të drejtën studentit për punim diplome dhe e bën atë publike.</p>	<p>Studentët e këtij programi, pas përmblyljes së gjithë detyrimeve dhe mbrojtjes së praktikës, kanë të drejtën e mbrojtjes së diplomës përmes një punimi (ku kriter është nota mesatare mbi 9.5) ose nëpërmjet dhënies së provimit të formimit si provim i përgjithshëm. Procedura e mbrojtjes përfundimtare, diplomimit, është e përcaktuar në rregulloren e Institucionit, në rregulloren e këtij programi, si dhe në një dokument të posaçëm për këtë program studimi “Program i provimit të formimit” ku jepen të gjitha modalitetet e këtij procesi. Ky proces zbatohet nga DESF. Këtu jepen detaje lidhur me grupin e lendeve të provimit të formimit. Gjithashtu në një dokument me vete (paketa e provës finale) jepen procesi i përgatitjes së punimit të diplomës, strukturën e punimit të diplomës,</p>




	<p>listën e pedagogëve udhëheqës, listën e sugjeruar të temave të mundshme orientuese etj. Dy nga studentet që në takuam gjate vizitës në institucion ishin të kursit të III-te dhe do të përgatitjes përfundimtare të punimit apo përgatitjes për provimin përfundimtar.</p> <p><i>Evidence nr.2.3. Programi i provimit të formimit</i> <i>Evidence nr.5. Paketa e provës finale</i> <i>Evidence nr.1. Rregullore e UB</i> <i>Evidence nr.3. Rregullore e programit të studimit Bachelor në FBSPP</i> <i>Evidentim nga vizita në institucion</i></p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>DESF, si njësi bazë e programit, së bashku me strukturat ndihmëse, informojnë, ndjekin dhe monitorojnë procesin e mbrojtjes së diplomës me punimin e diplomës. Pas marrjes së informacionit studentët plotësojnë formularin e aplikimit ku përcaktojnë fushën e studimit, strukturën paraprake të tij dhe propozimin për udhëheqësin e punimit. Në DESF përcaktohen udhëheqësit për çdo student, të cilët kanë përgjegjësi për mbarëvajtjen e këtij procesi, cilësinë dhe përfundimin në afat. Ky proces u evidentua edhe gjatë vizitës në institucion.</p> <p><i>Evidence nr.2.3. Programi i provimit të formimit</i> <i>Evidence nr.5. Paketa e provës finale</i> <i>Evidence nr.1. Rregullore e UB</i> <i>Evidence nr.3. Rregullore e programit të studimit Bachelor në FBSPP</i> <i>Evidentim nga vizita në institucion</i> <i>(Evidentim nga vizita në institucion)</i></p>
<p>Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p>	<p>Lidhur me diplomimin e studentëve, me vendim të përgjegjësit të DESF, ngrihet Komisioni i Provimit të Formimit i cili në vlerësimin e punimit të diplomës bazohet në katër kriter kryesore:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Ecurinë dhe nivelin e vlerësimit të marrë në mësim gjatë vitit akademik; • Vlerat teorike shkencore dhe profesionale të punimit; • Vlerësimin që jep pedagogu udhëheqës i punimit të studentit në formularin përkatës; • Nivelin e prezantimit të punimit nga studenti. <p><i>Evidence nr.2.3. Programi i provimit të formimit</i> <i>Evidence nr.5. Paketa e provës finale</i> <i>Evidence nr.2.4. Tezat e provimit të formimit. FBSPP</i> <i>Evidence nr.3. Rregullore e programit të studimit Bachelor në FBSPP</i> <i>Evidentim nga vizita në institucion</i></p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe në punimin e diplomës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i</p>	<p>Në funksion të fushës së punimit të propozuar nga studenti, DESF miraton listën e pedagogëve udhëheqës për temat e studentëve. Udhëheqësit e punimeve të diplomës gjatë periudhës së përgatitjes së tij nga studenti mbajnë komunikim të vazhdueshëm duke i orientuar përgjatë kësaj kohe. Roli udhëheqës i pedagogut është këshillues dhe orientues lidhur me përmbushjen e objektivave të qëllimit të punimit, shfrytëzimin e literaturës bashkëkohore nga studenti dhe përfshirja e analizës teorike praktike në punim.</p> <p><i>Evidence nr.2.3. Programi i provimit të formimit</i> <i>Evidence nr.5. Paketa e provës finale</i> <i>Evidence nr.1. Rregullore e UB</i></p>

plotë për t'u paraqitur para komisionit.	<i>Evidence nr.3. Rregullore e programit të studimit Bachelor në FBSPP Evidentim nga vizita në institucion</i>			
Kriteri 5. Njësia bazë asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.	Pedagoget përkatës që janë udhëheqës të punimeve të diplomimit mbështesin studentin për realizimin me sukses të punimit duke ofruar infrastrukturën teknike të institucionit kryesisht laboratorët si dhe të dhe data basë që kane në dispozicion. <i>Evidence nr.2.3. Programi i provimit të formimit Evidence nr.5. Paketa e provës finale Evidence nr.3. Rregullore e programit të studimit Bachelor në FBSPP Evidentim nga vizita në institucion</i>			
Kriteri 6. Në përfundim të provimit të përgjithshëm përfundimtar ose të mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.	Komisioni i Provimit të Formimit bazuar në katër kriteret e përmendura më lart, bën vlerësimin e punimit të diplomës me notë përfundimtare. në rregulloret përkatëse janë të përcaktuara edhe rastet e vlerësimit negativ të provimit përfundimtar si dhe kohe e lënë në dispozicion për studentin për tu rivlerësuar. Aktualisht nga ky program janë 5 të diplomuar. <i>Evidence nr.2.3. Programi i provimit të formimit Evidence nr.5. Paketa e provës finale Evidence nr.3. Rregullore e programit të studimit Bachelor në FBSPP</i>			
Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	Në përfundim të studimeve bazuar në rregulloret e përmendura me lart studentit pajiset me diplomën dhe suplementin e saj të miratuar nga MASR. Diplomës i bashkëngjitet edhe lista e notave. GVJ verifikoi që në këtë proces studentet nuk mund të pajisen me suplementin përkatës të diplomimit pasi ky i fundit nuk është miratuar nga Senati i UB në pritje të akreditimit të pare të këtij programi. <i>Evidence nr.3. Rregullore e programit të studimit Bachelor në FBSPP</i>			
Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.	Nga vizita në institucion rezulton se procesi i ruajtjes së gjithë dokumentacionit bazohet në kërkesat ligjore dhe aktet nënligjore në fuqi. Gjithashtu të dhënat e tij ruhen edhe në sistemin informativ të institucionit. GVJ evidentoi dhe kontrollon me zgjedhje dy dosje të studenteve të këtij programi të cilat kishin dokumentacionin e nevojshëm që në vitin e regjistrimit të tyre. <i>Evidentim nga vizita në institucion</i>			
Konkluzione	<i>GVJ bazuar në dokumentacionin e ofruar nga institucioni si dhe vizitën e realizuar në institucion konkludon se procedura e përmblyjes së studimeve në të dyja format; me punim diplome apo provim formimi është e plote dhe garanton një vlerësim të drejte të diplomimit të studentit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X


Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X



**IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA,
LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT**

Standardi IV.1																																																						
Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.																																																						
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve																																																					
<p>Kriteri 1. Personeli akademik dhe ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/ moduleve të programit, për fushën kërkimore ose eksperiencën praktike në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.</p>	<p>Personeli akademik i angazhuar në realizimin e këtij program plotëson kërkesat e legjislacionit në fuqi dhe akteve nënligjore. Mbështetur në CV e stafit akademik dhe të dhënat tabelore të RVB që ofron institucione evidentojmë se ai plotëson kriteret akademike dhe kualifikuese të përcaktuara në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.</p> <table border="1"> <thead> <tr> <th rowspan="2">Kualifikimi i stafit akademik të PS</th> <th colspan="2">2019-2020</th> <th colspan="2">2020-2021</th> <th colspan="2">2021-2022</th> </tr> <tr> <th>PAE</th> <th>PAK</th> <th>PAE</th> <th>PAK</th> <th>PAE</th> <th>PAK</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Prof. Dr</td> <td>1</td> <td>-</td> <td>-</td> <td>-</td> <td>-</td> <td>-</td> </tr> <tr> <td>Prof. Asoc.</td> <td>-</td> <td>-</td> <td>-</td> <td>-</td> <td>3</td> <td>-</td> </tr> <tr> <td>Dr/Phd</td> <td>6</td> <td>-</td> <td>6</td> <td>5</td> <td>6</td> <td>5</td> </tr> <tr> <td>Msc.</td> <td>3</td> <td>-</td> <td>5</td> <td></td> <td>6</td> <td>2</td> </tr> <tr> <td>Gjithsej</td> <td>11</td> <td>-</td> <td>11</td> <td>5</td> <td>15</td> <td>7</td> </tr> </tbody> </table>						Kualifikimi i stafit akademik të PS	2019-2020		2020-2021		2021-2022		PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK	Prof. Dr	1	-	-	-	-	-	Prof. Asoc.	-	-	-	-	3	-	Dr/Phd	6	-	6	5	6	5	Msc.	3	-	5		6	2	Gjithsej	11	-	11	5	15	7
	Kualifikimi i stafit akademik të PS	2019-2020		2020-2021		2021-2022																																																
		PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK																																															
	Prof. Dr	1	-	-	-	-	-																																															
	Prof. Asoc.	-	-	-	-	3	-																																															
	Dr/Phd	6	-	6	5	6	5																																															
Msc.	3	-	5		6	2																																																
Gjithsej	11	-	11	5	15	7																																																
<p>Kështu duke analizuar të dhënat tabelore lidhur me stafin akademik të programit gjatë 3 viteve të fundit shohim se institucioni ka bërë përpjekje për mbulimin e këtij programi me numrin e nevojshëm të stafit akademik që nga 11 anëtarë gjithsej në vitin akademik 2019-2020 arritën në 22 anëtarë staf akademik në vitin e studimit 2021-2022 në këtë vit pesha e Personelit Akademik me Kontratë (PAK) ndaj numrit gjithsesi të stafit akademik të programit është rreth 32 % që duhet konsideruar disi e lartë, por e justifikueshme kjo po të kemi parasysh numrin e ulët të studentëve të regjistruar gjatë këtyre viteve. Nga analiza e angazhimit të stafit në dy vitet e mëparshme shohim që nr i stafit akademik si PAK ka ardhur në rritje nga 5 anëtarë në 7 anëtarë staf akademik.</p> <p><i>Mendojmë që institucioni të shikojë mundësinë të rritjes së peshës specifike në mësimdhënie të PAE si dhe të rrisë kualifikimin e tij me shume anëtarë që zotërojnë grade shkencore apo titull akademik.</i></p> <p><i>Evidence nr.30. Tabelat aneks të RVB tabela nr. 6</i></p>																																																						
<p>Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e paraqitur për vitin akademik 2022-2023 PAE zhvillon rreth 68 % të ngarkesës mësimore në auditor kundrejt 32 % që zhvillon PAK. Edhe pse PAE i programit mbulon ngarkesën mësimore të programit në limitet e kornizën ligjore, institucioni duhet të shikojë në të ardhmen për rritjen e peshës specifike të realizimit të ngarkesës mësimore nga PAE.</p> <p><i>Evidence nr.30. Tabelat aneks të RVB tabela nr. 4 12</i></p>																																																					
<p>Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit</p>	<p>Bazuar në të dhënat e deklaruara nga institucioni shikojmë që numri i stafit akademik që mbulon këtë program ka ardhur në rritje dhe që përben një premise qëndrueshmërie në këtë drejtim.</p>																																																					

<p>akademik efektiv të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.</p>	<p>Kritja e numrit të stafit akademik ka ardhur si për PAE ashtu edhe për PAK.</p> <p><i>Evidence nr.30. Tabelat aneks të RVB tabela nr. 2 dhe 6</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të publikuara e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>Kriteret e shpallura për rekrutimet e reja të stafit akademik përcaktojnë kritere të përgjithshme dhe kritere specifike, ku këto të fundit përcaktohen nga DESF që mbulon këtë program studimi. Ndër kriteret specifike janë edhe njohja apo zhvillimi i lëndëve për të cilat do rekrutohet, bazuar në programin ku ato zhvillohen, apo preferencat për përfundim studimesh jashtë vendit në fushën përkatëse në institucion njësia përgjegjëse e rekrutimit është Zyra e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore (ZMBNJ). Rekrutimi kalon neper dy faza, shqyrtimi i dokumentacionit të dosjeve të aplikanteve dhe intervista e kandidatëve që kalojnë verifikimin dokumentar. Komisioni i ngritur harton vendimmarrjen e tij ku janë renditur sipas pikëve kandidatet dhe nëpërmjet titullarit të njësisë kryesore (FEQD të UB) ja përcjellë titullarit të UB i cili bën miratimin përfundimtar të fituesit.</p> <p><i>Evidenca nr.7. Manuali i Menaxhimit të Burimeve Njerëzore</i></p> <p><i>Vizite në institucion</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p>	<p>UB dhe FEQD si njësia kryesore ofron personel ndihmës mësimor shkencor dhe infrastrukturën e nevojshme për realizimin e orëve laboratorike apo shërbime të tjera në funksion të procesit mësimor. në laboratorin e FEQD zhvillohen punë laboratorike sidomos për temat që lidhen me përpunimin e të dhënave ekonomiko financiare. Orët në laborator zhvillohen nga pedagogu përkatës, ndërsa personeli ndihmës që është pjese e stafit të UB dhe FEQD si dhe personi përgjegjës në laborator orienton studentët lidhur me anën teknike të përdorimit dhe mirëmbajtjes së pajisjeve. <i>Vizita në institucion</i></p>
<p>Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtarit në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.</p>	<p>Bazuar në rregulloren e UB si dhe në Manualin e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore në nivel institucional është krijuar Zyra e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore (ZMBNJ) e cila një nder funksionet ka edhe ndjekjen e procedurave të punësimit të personelit akademik dhe jo akademik si dhe ruan dhe përditëson të dhënat e personelit akademik dhe ndihmës akademik. Nga takimi me personelin e Zyra e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore (ZMBNJ), por edhe nga dokumentacioni i vendosur në dispozicion, kjo zyrë është përgjegjëse për të ruajtur të gjithë dokumentacionin procedural lidhur me stafin që angazhohet në Fakultet, ruajtjen dhe përditësimin në çdo vit akademik të të dhënave të personelit efektiv dhe atij me kontratë. Zyra ka ndjekur procedurat për rekrutimin e personelit, ku kriteret i përcakton Departamenti përkatës, në vijim priten aplikimet, kontrollohen nga personeli përgjegjës dhe procedohen për interviste. ZMBNJ është pjesë e të gjitha hallkave të procesit të rekrutimit dhe ndjekjes së progresit të stafit, duke siguruar transparencën dhe përmbushjen e kërkesave ligjore dhe institucionale. Nga shqyrtimi i dy dosjeve të rastësishme nuk u vërejtën mangësi në dokumentacion. Nga</p>



	<p>përzgjedhja e dosjeve të stafit të programit gjatë vizitës në institucion, rezultoi se në dosjet e përzgjedhura në mënyrë rastësore, gjendet dokumentacioni si: kontrata e punës, diploma dhe lista e notave të noterizuara të studimeve universitare, masterit, doktorata, CV, etj. Po kështu, në dosjet e stafit akademik, ka edhe të dhëna lidhur me kualifikimet, pjesëmarrjen në veprimtari kërkimore dhe akademike, brenda dhe jashtë vendit.</p> <p><i>Evidenca nr.7. Manuali i Menaxhimit të Burimeve Njerëzore</i></p> <p><i>Vizita në institucion</i></p>			
<p>Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>Stafi akademik që mbulon këtë program është angazhuar në ndjekjen e procesit të praktikës profesionale të studentëve pranë këtyre institucioneve.</p> <p>Nga vizita në institucion, në takimin me stafin që mbulon këtë program, GVJ evidentoi që anëtarë të stafit janë caktuar për të ndjekur si praktikën e studentëve të këtij viti akademik që tashmë e kishin përfunduar, ashtu edhe si drejtues për punimin e diplomës.</p> <p><i>Evidenca nr.2.3.2.Paketa e praktikës Bachelor 2021-2022</i></p> <p><i>Evidenca 2.3.3.Lista e studenteve dhe institucioneve ku është kryer praktika profesionale</i></p>			
<p>Kriteri 8. Personeli mbikqyrës në ambientin pritis që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve/raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.</p>	<p>Nga takimin me stafin e programit evidentuam rolin e tyre në monitorimin e praktikës profesionale si dhe në ndihmën e dhënë në hartimin e raportit që student dorëzon në fund të këtij procesi.</p> <p><i>Vizite në institucion</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ bazuar në dokumentacionin e ofruar nga institucioni si dhe vizitën e realizuar në institucion konkludon se megjithëqë rritjen e numrit të stafit akademik nga viti në vit që nga fillimi i tij, institucioni duhet të beje përpjekje paralele që krahas rritjes së numrit të studenteve të regjistruar të rrisë dhe numrin e PAE dhe për rrjedhojë edhe ngarkesën mësimore që ata mbulojnë. Gjithashtu duhen bere përpjekje edhe për rritjen e kualifikimit akademik të tyre me zotërim tituj akademik.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

Standardi IV.2	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e paraqitur si dhe nga vizita e GVJ në ambientet e UB dhe të FEQD evidentojmë që institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore UB zotëron 2 kampuse. Kampusi 2 ku edhe zhvillohet program i studimit ka një sipërfaqe të shfrytëzueshme 6451 m². Ambientet mësimore (sallate leksioneve, të seminareve, laboratorit, zyrat e stafit mjediset sportive janë në funksion të zhvillimit të programit dhe janë të përshtatshme duke plotësuar kriteret standard. Bazuar në informacionin e institucionit mjediset e FEQD ofrojnë normën prej 14.1 m² për student (4362 m²/310 studente).</p> <p><i>Evidence 9.2. Mjediset e FEQD përgjegjës për programin e studimit</i> <i>Evidence nr.94. Relacion për infrastrukturën në funksion të programit</i> <i>Evidence nr.30. Tabelat përmbledhëse të RVB, tabela nr.16</i> <i>Vizita në mbetjet e UB</i></p>
<p>Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>Nga konstatimi gjatë vizitave në institucion, u vu re që ambientet janë të mjaftueshme për realizimin e programit të studimit. Këto ambiente përfshijnë sallat, zyrat, laboratorët. FEQD dhe DESF kanë ambientet e mjaftueshme në dispozicion për të realizuar me performancë të mirë këtë program. FEQD ofron ambiente që plotësojnë kriteret teknike si edhe normativën e sipërfaqes së shfrytëzueshme, referuar VKM Nr. 418, datë 10.05.2017 "Për standardet, kriteret dhe procedurat për hapjen, riorganizimin, ndarjen, bashkimin ose mbylljen e institucioneve të arsimit të lartë dhe degëve të tyre", sipas të cilit kërkohen 2.5 m² / student.</p> <p>Mjediset ku zhvillohet procesi mësimor përmbajnë të gjitha aparaturat dhe mjetet e nevojshme për plotësimin e kërkesave të moduleve dhe objektivave formuese të programit të studimit.</p> <p><i>Evidence nr.30. Tabelat përmbledhëse të RVB, tabela nr.16</i> <i>Konstatime të GVJ gjatë vizitës në institucion (FEQD të UB)</i></p>
<p>Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>Mjediset mbështetëse të mësimdhënies si laboratorët apo mjediset e tjera janë të pajisura me bazën teknologjike të përshtatshme, kompjuterë, vidioprojektore, tabela të lëvizshme etj duke plotësuar standardet e kërkuara.</p> <p><i>Evidence nr.30. Tabelat përmbledhëse të RVB, tabela nr.16</i> <i>Evidence nr.94. Relacion për infrastrukturën në funksion të programit</i> <i>Konstatime të GVJ gjatë vizitës në institucion (FEQD të UB)</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale</p>	<p>Bazuar në informacionin e institucionit dhe vizitën në ambientet e UB, në funksion të zhvillimit të mësimin të programeve të studimit që ofron FEQD evidentuam 2 laboratorë që janë në shërbim të procesit mësimor dhe studenteve.</p> <p><i>Evidence nr.30. Tabelat përmbledhëse të RVB, tabela nr.16</i></p>

sipas natyrës së programit të studimit që ofron.	<i>Evidence nr.94. Relacion për infrastrukturën në funksion të programit Konstatime të GVJ gjate vizitës në institucion (FEQD të UB)</i>			
Konkluzione	<i>GVJ bazuar në dokumentacionin e ofruar nga institucioni si dhe vizitën e realizuar në institucion konkludon se mjediset mësimore dhe infrastruktura e ofruar në funksion të zhvillimit të programit janë të përshtatshme për një zhvillim normal të tij. Ambienti i kampusit 2 të UB ku edhe zhvillohet ky program është bashkëkohor dhe komod në funksion të qëllimit të tij.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.3	
Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.	<p>Bazuar në dokumentacionin e aplikimit nga institucioni si dhe në vizitën që GVJ realizoi në ambientet e bibliotekës se FEQD të UB evidentojmë që për modulët/ lëndet e programit studenteve u ofrohet dhe literatura baze dhe ndihmese siç edhe janë të përcaktuara në syllabuset përkatëse. Në mbështetje të procesit të mësim nxënies FEQD i UB ka në funksionim edhe bibliotekën pranë Kampusi 2 ku edhe zhvillohet ky program dhe ku studentet kanë mundësi të marrjes se teksteve apo literaturës fizike ashtu edhe literature digjitale nëpërmjet platformës online të menaxhimit të librit.</p> <p><i>Evidence nr.24.Bibloteka në UB</i> <i>Evidence 24.1.Te dhëna për platformat online</i> <i>Evidencë nr.24.4. Relacion për infrastrukturën në funksion të programit.</i> <i>Evidence nr.30. Tabelat përmbledhëse të RVB. Tabela nr.17.</i> <i>Konstatime të GVJ gjate vizitës në institucion (FEQD të UB)</i></p>
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësimet të literaturës me botime të viteve të fundit.	<p>Megjithëse DESF në Tetor 2022 ka bere kërkesë për tekste te tjerë mësimorë ku përfshihen disa tekste për këtë program, mendojmë se numri i titujve të librave në shqip dhe gjuhe të huaj duhet të jenë me i larte duke plotësuar me tej fondin e bibliotekës.</p> <p><i>Evidence nr.24.Bibloteka në UB</i> <i>Evidence 24.1.Te dhëna për platformat online</i> <i>Evidencë nr.24.4. Relacion për infrastrukturën në funksion të programit.</i> <i>Evidence nr.30. Tabelat përmbledhëse të RVB. Tabela nr.17.</i> <i>Konstatime të GVJ gjate vizitës në institucion (FEQD të UB)</i></p>
Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	<p>Bazuar në dokumentacion dhe vizitën në FEQD të UB, u konstatua se në dispozicion të studentëve të programit vihet edhe Biblioteka e Fakultetit e vendosur në godinën ku zhvillohet mësimi i programit të përfshirë në Kampusin 2 të universitetit. Në mjediset e kësaj Biblioteke studentët kanë mundësi të barabarta për të marrë shërbime si për të studiuar ashtu edhe për të shfrytëzuar literaturën që ofrohet. Orari dhe shërbimi i ofruar është në funksion të nevojave të studentëve. Mjediset e Bibliotekave janë të</p>



	<p>hapura edhe në fundjavë. Kjo bibliotekë ofron mundësinë e kërkimit dhe gjetjes së librave online në sallën e leximit nëpërmjet 5 kompjuterëve të vendosur për këtë qëllim.</p> <p><i>Evidence nr.24.Bibloteka në UB</i> <i>Evidence 24.1.Te dhëna për platformat online</i> <i>Evidencë nr.24.4. Relacion per infrastrukturën në funksion të programit.</i> <i>Evidence nr.30. Tabelat përmbledhëse të RVB. Tabela nr.17.</i> <i>Konstatime të GVJ gjate vizitës në institucion (FEQD të UB</i></p>
<p>Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikes së programit të studimit.</p>	<p>Nga vizita në institucion rezulton se Biblioteka është relativisht e pajisur me literaturë fizike (rreth 4250 tituj) në shqip dhe anglisht, që përfshijnë tekste mësimore, libra, revista periodike/ buletine të institucioneve punime mikroteze dhe doktorate etj. Shërbimi në bibliotekë mbulohet nga punonjës të caktuar dhe ofrohet në dy ambientet e veçara por pranë njeri tjetrit, në vendin e tërheqjes së librave dhe sallën e hapur për studim.</p> <p><i>Evidence nr.24.Bibloteka në UB</i> <i>Evidence 24.1.Te dhëna për platformat online</i> <i>Evidencë nr.24.4. Relacion për infrastrukturën në funksion të programit.</i> <i>Evidence nr.30. Tabelat përmbledhëse të RVB. Tabela nr.17.</i> <i>Konstatime të GVJ gjate vizitës në institucion (FEQD të UB</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.</p>	<p>Shërbimet aktuale që ofron biblioteka u ofrojnë akses të barabartë përdoruesve potencial (studentëve dhe stafit akademik) dhe pa kosto pasi ata anëtarësohen pranë saj. Gjithashtu, biblioteka ofron shërbimin online me platformën digjitale të menaxhimit të librave si dhe ECONBIZ me kontrate të përhershme. Biblioteka on linë realizohet edhe nëpërmjet kontratës për vitin 2022-2023 JSTOR dhe SEARCH 4LIFE që u mundëson përdoruesve të saj akses në baza të dhënash apo informacion të dobishëm në fushën e ekonomisë për të analizuar dhe përdorur në punime kërkimore shkencore.</p> <p><i>Evidence nr.24.Bibloteka në UB</i> <i>Evidence 24.1.Te dhëna për platformat online</i> <i>Evidencë nr.24.4. Relacion për infrastrukturën në funksion të programit.</i> <i>Evidence nr.30. Tabelat përmbledhëse të RVB. Tabela nr.17.</i> <i>Konstatime të GVJ gjate vizitës në institucion (FEQD të UB</i></p>
<p>Kriteri 6. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.</p>	<p>Ekziston një program kompjuterik i përdorur nga biblioteka për gjetjen e titujve të librave. Po ashtu kompjuterët e gjetur në bibliotekë mund të shfrytëzohen nga studentët pa kufizime. Studentet kanë akses të plotë për të siguruar botime online edhe nëpërmjet disa adresave që janë funksionale për bibliotekën elektronike.</p> <p><i>Evidence nr.24.Bibloteka në UB</i> <i>Evidence 24.1.Te dhëna për platformat online</i> <i>Evidencë nr.24.4. Relacion për infrastrukturën në funksion të programit.</i> <i>Evidence nr.30. Tabelat përmbledhëse të RVB. Tabela nr.17.</i> <i>Konstatime të GVJ gjate vizitës në institucion (FEQD të UB</i></p>
<p>Kriteri 7. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre,</p>	<p>Biblioteka ka orarin 8.30 me 19.45 duke ofruar shërbime edhe për studentet e të gjitha programeve një pjese e të cilave e zhvillojnë mësimin pasdite. Kompjuterët e vene në dispozicion të stafit akademik dhe studenteve u mundësojnë që nëpërmjet platformës digjitale të menaxhimit të librit behet kërkimi dhe marrja e tij në kohe të shkurtër. Ky kërkim</p>

<p>në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.</p>	<p>mund të behet edhe në ambientet e tjera jashtë bibliotekës duke përdorur këtë platforme.</p> <p><i>Evidence nr.24.Bibloteka në UB</i> <i>Evidence 24.1.Te dhëna për platformat online</i> <i>Evidence nr.24.4. Relacion për infrastrukturën në funksion të programit.</i> <i>Evidence nr.30. Tabelat përmbledhëse të RVB. Tabela nr.17.</i> <i>Konstatime të GVJ gjate vizitës në institucion (FEQD të UB</i></p>			
<p>Kriteri 8. Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.</p>	<p>GVJ bazuar në dokumentacionin e aplikimit për akreditim dhe vizitës në institutin evidenton komunikim institucional (Rekomandim i Rektorit për pasurimin e bibliotekës) ashtu edhe nga njësia baze (Kërkesë e DESF për pasurimin e fondit të bibliotekës).</p> <p>Gjate vizitës në ambientet e bibliotekës ne evidentuam përdorimin nga anëtarë të stafit të FEQD si dhe studenteve të literaturës dhe përdorimin e ambienteve në funksion të studimit të tyre.</p> <p><i>Evidence nr.24.2. Rekomandim i Rektorit për pasurimin e bibliotekës</i> <i>Evidence 24.3. (Kërkesë e DESF për pasurimin e fondit të bibliotekës</i> <i>Evidence nr.30. Tabelat përmbledhëse të RVB. Tabela nr.17.</i> <i>Konstatime të GVJ gjate vizitës në institucion (FEQD të UB</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ bazuar në dokumentacionin e ofruar nga institucioni si dhe vizitën e realizuar në institucion konkludon se institucioni ofron mjedise të posaçme për studim dhe bibliotekë me një fond literature relativisht të pasur në funksion të procesit të mësimdhënies për stafin dhe studentet. Stafi akademik dhe studentet kane akses në bibliotekën dixhitale nëpërmjet disa platformave online për të cilat institucioni ka kontrata shërbimi. Bazuar edhe në syllabuset e lendeve të programit institucioni duhet të pasuroje me tej fondin e bibliotekës me literature me të fundit dhe të përfshije me shume tekste ndërkombëtare studentesh në fushën e Financës të cilat tashme një pjese e tyre janë edhe përkthyer në gjuhen shqipe dhe janë bere pjese e bibliotekave të IAL në Shqipëri.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	


Standardi IV.4

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të</p>	<p>Administrimi i informacionit që lidhet me studentet dhe aktivitetin e tyre mbulohet nga njësitë e veçanta të FEQD të UB, si sekretaria mësimore,</p>

<p>cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.</p>	<p>zyra e rekrutimit dhe e pranimit, dekanati i studenteve si dhe klubet studentore. GVJ gjate vizitës realizoi takime dhe monitorime pranë sekretarisë mësimore të FEQD të UB, ku evidentoi administrimin korrekt të informacionit për studentet që në fazën e regjistrimit të tyre deri në procesin e diplomimit. GVJ evidentoi regjistrat themeltar që mbahet për studentet e këtij programi ku beri edhe verifikimet me zgjedhje në 4 raste, dosjet e studenteve në fillim të procesit mësimor, regjistrat e grupeve, procesverbalet e vlerësimit, hedhjen e tyre në regjistrin themeltar etj. Institucioni përdor platforma të menaxhimit të informacionit për studentet (portali studentor ku studenti merr informacion mbi vlerësimin, stafin akademik etj dhe platforma Classroom)</p> <p>Institucioni nëpërmjet faqes së tij zyrtare pasqyron informacionin me karakter akademik, administrativ kulturor e social.</p> <p><i>Evidence nr.44.Udhezues për përdorimin e strukturës se Teknologjisë se Informacionit në UB</i></p> <p><i>Vizita e GVJ në ambientet e sekretarisë mësimore të FEQD të UB</i></p>
<p>Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p> <p>Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Monitorimi në kohë reale i aktivitetit të personelit akademik dhe administrativ të këtij programi bëhet nga ZMBNJ, Sekretaria e Përgjithshme dhe Sekretaria Mësimore. Raportet e monitorimit në lidhje me orarin e mësimit, ngarkesën mësimore, etikën e komunikimit etj, përcillen në njësinë kryesore dhe atë baze nëpërmjet formave të përmendura me lart. Personeli dhe studentet pas kërkesës se tyre kanë akses informacioni që zotërohet nga Sekretaria mësimore. Se fundmi është ngritur dhe funksionon Sistemi i Menaxhimit të Informacionit (SIM) që u jep mundësi aksesit përdoruesve (pedagoge, student Dege e IT etj) lidhur me monitorimin e orëve mësimore, formularët e matjes dhe vlerësimit të performances, planin e ngarkesës mësimore etj.</p> <p><i>Evidence nr.44.Udhezues per përdorimin e strukturës se Teknologjisë se Informacionit në UB</i></p> <p><i>Vizita e GVJ në ambientet e sekretarisë mësimore të FEQD të UB</i></p>
<p>Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.</p>	<p>Institucioni, FEQD i UB sigurojnë informacionin e nevojshëm edhe nëpërmjet platformës se studentit, platformës SIS Cluster si dhe platformave e-learning në Google classroom dhe Microsoft Teams. Rrjetet sociale të njohura tashmë në tregun e informacionit janë mjete të tjera në funksion të marrjes dhe dhënies së informacionit që mbështetet me infrastrukturën e duhur. Sistemet e përmendura me lart mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit mes personelit akademik dhe ndihmës me studentët Gjate zhvillimit të mësimit online në kushtet e pandemisë institucioni përdori dhe konsolidoi përdorimin e platformat e mësipërme. Përdorimi elektronik përmes e-mail-it vazhdon të jete forme kryesore e komunikimit .</p> <p><i>Evidence nr.44.Udhezues për përdorimin e strukturës se Teknologjisë se Informacionit në UB</i></p> <p><i>Vizita e GVJ në ambientet e sekretarisë mësimore të FEQD të UB</i></p>




<p>Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.</p>	<p>Sistemi i Menaxhimit të Informacioni i bere ku përfshihen të gjitha platformat dhe mjetet e informacionit të përmendura, mundëson monitorimin dhe dhënien e informacionit të veprimtarisë administrative dhe akademike të institucionit në kohe reale.</p> <p><i>Evidence nr.44.Udhezues për përdorimin e strukturës së Teknologjisë së Informacionit në UB</i></p> <p><i>Vizita e GVJ në ambientet e sekretarisë mësimore të FEQD të UB</i></p>			
<p>Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.</p>	<p>Nga konstatimi i GVJ, faqja e internetit e institucionit dhe e FEQD të UB përfshin informacionin lidhur me programin dhe stafin dhe njoftime të ndryshme që kanë të bëjnë me datat e provimeve, orarin e studimeve mundësi punësimesh etj. Përveç kësaj, UB është shumë aktive edhe në rrjetet sociale, në të cilat ka gjithnjë informacion lidhur me programin si dhe me aktivitete të tjera që organizon Universiteti dhe Fakulteti. Institucioni bën përditësimin e faqes se vet të internetit rrjeteve sociale etj.</p> <p><i>Evidence nr.44.Udhezues për përdorimin e strukturës së Teknologjisë së Informacionit në UB</i></p> <p><i>Vizita e GVJ në ambientet e sekretarisë mësimore të FEQD të UB</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ bazuar në dokumentacionin e ofruar nga institucioni si dhe vizitën e realizuar në institucion konkludon se sistemi i brendshëm i menaxhimit të informacionit në funksion të administrimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik plotëson standardet në shërbim të procesit mësimor, stafit akademik dhe studenteve të programit.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p>X</p>

<p>Standardi IV.5</p>	
<p>Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.</p>	<p>Në dokumentet e paraqitura nga institucioni përfshihet një raport financiar vjetor i Shoqërisë Barleti SH.P.K., pasqyrat mbi të ardhurat dhe financimet për tre vitet e fundit si dhe preventivi i këtij programi. Shikojmë se të ardhurat e veprimtarisë janë rritur gjate 3 viteve të fundit. Nga dokumentet e disponoheshim vihet re se burimet financiare të Institucionit janë kryesisht tarifat e studimeve, donacionet dhe të ardhura të tjera nga aktivitetet e shoqërisë Barleti. Lidhur me këtë program institucioni ka hartuar preventivin e programit të studimit Bachelor në FBSPP ku përfshihen burimet e të ardhurave dhe kostot përkatëse. <i>Numri i ulet i studenteve rrjedhimisht është faktori kryesor që në preventiv rezultati financiar të jete negativ dhe financimi të gjendet nga zëra të tjerë të veprimtarisë së Shoqërisë Barleti.</i></p>

	<p><i>Evidencë nr.28.Burimet e Financimit të UB</i> <i>Evidence nr.28.1.Preventimi i programit të studimit FBSPP</i> <i>Evidence nr. 28.4. Raporti financiar vjetor i UB</i> <i>Evidence nr.30. Tabelat përmbledhëse të RVB Tabela nr.18.</i></p>
<p>Kriteri 2. Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologji mbështetëse të procesit mësues, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.</p>	<p>Në pasqyrat financiare (jo në planin e financimit) paraqiten të gjitha burimet e të ardhurave dhe kostot të ndara në baze të llojit të tyre. Aty përfshihen të ardhura nga aktiviteti kryesor dhe dytësor. Në raportin e të ardhurave nga financime të ndryshme identifikohen edhe burimet e të ardhurave të Institucionit. Ndërsa për sa i përket shpenzimeve ato grupohen në shpenzime të personelit, shpenzime konsumi dhe amortizime dhe shpenzimet të tjera shfrytëzimi etj. GVJ mendon se hartimi i një plani financiar gjithëpërfshirës do të bëjë të mundur të analizoje të gjithë të ardhurat dhe shpenzimet sipas natyrës së tyre specifike. Kjo duhet shoqëruar me detajim në rang programi në mënyrë që të intensifikohet procesi i marketingut me qëllim rritjen e numrit të studenteve të regjistruar në këtë program duke e bërë atë të qëndrueshëm financiarisht. <i>Evidencë nr.28.Burimet e Financimit të UB</i> <i>Evidence nr.28.1.Preventimi i programit të studimit FBSPP</i> <i>Evidence nr. 28.4. Raporti financiar vjetor i UB</i> <i>Evidence nr.30. Tabelat përmbledhëse të RVB Tabela nr.18.</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.</p>	<p>Shoqëria Barleti SH.P.K ka kryer auditime të brendshme dhe të jashtme të përvitshme nëpërmjet të cilave evidenton gjendjen financiare, dhe raportet e efektivitetit. Pasqyrat financiare përmbajnë informacion të hollësishëm mbi të ardhurat dhe shpenzimet dhe shoqërohen me shënime të cilat analizojnë fitueshmërinë, efektivitetin dhe vazhdueshmërinë e institucionit. Po ashtu raporti i audituesit të jashtëm (psh raporti i vitit 2011) përpilohet në lidhje me raportet financiare. Evidentojmë se në raportin e audituesit të jashtëm (nga shoqëria “Grant Thorton” si auditues i pavarur) theksohet zbatimi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit nga shoqësia. <i>Evidence nr.28.2 Raporti i audituesit të brendshëm (2021)</i> <i>Evidence nr.28.3 Raporti i audituesit të jashtëm (2021)</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.</p>	<p>Bazuar në procedurat e brendshme të UB planifikimi dhe zbatimi buxhetor materializohen në planet financiare vjetore dhe miratohen në Bordin e Administrimit. Bazuar në preventivin e programit DESF informohet për këtë aspekt financiar gjë që duhet të rrisë me tej angazhimin e stafit akademik por edhe me gjere për të rritur të ardhurat financiare të programit nëpërmjet rritjes së numrit të studenteve të këtij program. <i>Evidence nr.28.1.Preventimi i programit të studimit FBSPP</i> <i>Evidence nr. 28.4. Raporti financiar vjetor i UB</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin financiar të UB shikojmë se institucioni gjate 3 viteve të fundit ka reflektuar qëndrueshmëri financiare si në rritjen e burimeve të të ardhurave ashtu edhe në rezultatin financiar. <i>Nga ana tjetër numri i ulet i studenteve të 3 viteve të fundit të këtij programi jep rezultat financiar negativ duke rrezikuar qëndrueshmërinë financiare</i></p>

<p>mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programeve të studimeve.</p>	<p>të programit dhe duke ndikuar në financimin e saj nga burimet e tjera financiare të institucionit. Institucioni ka dëshmuar ndër vite se të ardhurat e tij janë të mjaftueshme për të mbuluar shpenzimet e për të gjeneruar fitime. <i>Evidence nr. 28.4. Raporti financiar vjetor i UB</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ bazuar në dokumentacionin e ofruar nga institucioni si dhe vizitën e realizuar në institucion konkludon se institucioni demonstroi qëndrueshmëri financiare duke garantuar financimin dhe mbështetjen financiare për realizimin e procesit mësimor kërkimor dhe si rrjedhojë mbarëvajtjen e këtij program. Institucioni duhet të rrisë përpjekjen që nëpërmjet rritjes në të ardhmen të studenteve në këtë program të arrijë edhe qëndrueshmërinë financiare të vete programit.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	




V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p>	<p>UB dhe fakulteti respektiv kane hartuar gjithë dokumentacionin e nevojshëm që përbën kuadrin e plotë për procedurat e pranimit dhe të hyrjes së studentëve në programin e studimit dhe progresin e tyre akademik në të tre vitet e studimit. Janë hartuar rregulloret e funksionimit të fakultetit të Ekonomisë, Qeverisjes dhe Drejtësisë, në të cilën është implementuar programi i studimeve Bachelor në Financë, Bankë, Sigurime dhe Pasuri të paluajtshme. (Evidenca 1.2, 1.3, 3, Evidenca 20, 20.1, 20.2, 20.3, 20.4 dhe 20.5). Universiteti ndjek progresin dhe ecurinë e studentit në të gjithë karrierën e tij tre vjeçare duke ndjekur dhe zbatuar ligjin “Për arsimin e lartë”, Vendimin numër 41 të Këshillit të Ministrave, datë 24.01.2018, ndryshuar me VKM 879, datë 18.12. 2019.</p> <p>Në aktet që shoqërojnë Raportin e vlerësimit të brendshëm shprehet qartë se në universitet ka struktura të posaçme dhe të mirëorganizuara, që janë njëherësh funksionale, lidhur me shërbimet në interes të studentëve, nga hyrja e tyre në universitet deri në çastin e diplomimit të tyre. Këto struktura drejtohen nga zv/rektori që mbulon çështjet studentore dhe që nënkuptojnë: zyrën e rekrutimit, zyra e pranimit dhe e regjistrimit, Dekanatin e studentëve dhe të vetë organizimit studentor, zyra e Alumnit dhe e karrierës. (Evidenca 20.5, Portali Studentor UB; Evidenca 20.6, plani strategjik i zyrës së Alumnit dhe karrierës 2020-2025; Evidenca 20.7, Plani i punës i zyrës së Alumnit për periudhën 2020-2021, Evidenca 20.7.1, Raport Zyra e Alumnit dhe e karrierës; Evidenca 20.8, Aktivitete dhe trajnime profesionale për studentët e programit Bachelor në FBSPP) Këto përfundime u konfirmuan edhe prej takimit në universitet të grupit të vlerësimit të jashtëm me studentët e viteve të ndryshme të regjistruar në programin e studimeve Bachelor në FBSPP.</p> <p><i>Evidence nr.1 Rregullore e UB</i> <i>Evidence nr.3.Rregullore e programit te studimit</i> <i>Evidence nr.21.1.Rregullore e zyrave studentore dhe këshillimit te karrierës.</i></p>
<p>Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Procedurat e rekrutimit, pranimit regjistrimit, studimeve dhe të daljes nga programi i studimeve bachelor në FBSPP janë të miratuara nga strukturat respektive, janë bërë publike, njihen prej studentëve apo ju bëhen atyre të ditura në seancë të caktuara apo nëpërmjet afishimit të procedurave në vende të posaçme. Të gjithë studentët janë të barabartë përballë procedurave. Ato garantojnë njëherësh edhe të drejtat dhe liritë themelore të studentëve të regjistruar, ashtu sikurse për të gjithë studentët e UB. Studentët e shprehin publikisht faktin e të qenit të barabartë dhe të mirë informuar lidhur me të gjitha procedurat e pranimit, hyrjes dhe deri në dalje të programit të studimeve.</p> <p><i>(Evidencat: 1, 1.3 dhe 1.4)</i></p>

	<p><i>Evidence nr.1 Rregullore UB</i> <i>Evidence nr.3.Rregullore e programit te studimit</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj.</p>	<p>Evidenca 18, Manual për rekrutimin, aplikimin, regjistrimin dhe transferimin e studentëve në Universitetin Marin Barleti, tregon qartë kriteret e veçanta të përzgjedhjes së kandidatëve për programin e studimeve Bachelor në FBSPP.</p> <p>Universiteti bashkëpunon me strukturat e posaçme dhe institucionet e maturës shtetërore. Ka rregullore të posaçme për transferimin dhe regjistrimin në UB. Ka vendime të posaçme të Senatit akademik</p> <p><i>Evidenca 18.1; Verifikimi i kapaciteteve pritëse</i> <i>Evidenca 19, Rregullore e Funkcionimit te Sekretarisë</i> <i>Evidenca 19.1. Rregullore e brendshme për transferim dhe regjistrim te studenteve</i></p>
<p>Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>Procedura e organizuar për pranimin në një farë mënyre është procedurë e detyruar për tu njohur prej të gjithë studentëve të programit të studimit bachelor në FBSPP. Studentët janë të detyruar që ti njohin këto kritere, të cilat janë të qarta, të kuptueshme, lehtësisht të asimilueshme, dhe të përdorshme prej kujtdo që është i interesuar.</p> <p>Po kështu janë lehtësisht të përdorshme dhe të kuptueshme edhe kriteret dhe procedurat e regjistrimit, të transferimit.</p> <p>Ato janë të bëra publike në faqen dhe webin e universitetit.</p>
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.</p>	<p>Universitet dhe fakulteti kanë politikat e tyre të përgjithshme të rekrutimit por edhe politikën e tyre të pranimit të veçantë për çdo program studimi dhe për çdo vit akademik. Kriteret hartohen paraprakisht në fillimin e çdo viti të ri akademik. Me gjithë që numri i studentëve të regjistruar në këto 3-4 vitet e fundit ka qënë relativisht i ulët dhe modest, megjithëqë që kriteret njihen dhe kanë qënë të bëra publike, <i>vlerësojmë se këto kritere nuk janë promovuar mirë dhe se ky program studimesh mund të njihej më mirë.</i> Ndërkohë theksohet se për studentët që kanë hyrë në program, gjithçka është e qartë dhe e njohur mirë.</p> <p>Informacionet e nevojshme lidhur me kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të studimit dhe të pranimit, janë të bëra publike edhe në faqen e universitetit.</p> <p><i>Evidence nr.18. Manuali për rekrutimin, Aplikimin, regjistrimin dhe transferimin e studenteve</i> <i>Evidenca 19.1. Rregullore e brendshme për transferim dhe regjistrim te studenteve</i></p>
<p>Kriteri 6. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.</p>	<p>Me gjithë që institucioni harton dhe publikon rregullisht në fillim të çdo viti kriteret e përgjithshme dhe ato të veçanta për këtë program studimi, nuk na rezulton që të ketë kritere të veçanta për student dhe kandidatë me të dhëna të veçanta apo me prirje të veçanta.</p> <p>UB ka në fakt një profil të veçantë në rekrutimin e kandidatëve dhe të maturanëve me prirje sportive dhe aftësive dhe prirje të rralla.</p>
<p>Kriteri 7. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti</p>	<p>Kriteret që harton universiteti për pranimin dhe rekrutimin e studentëve në programin e studimit bachelor në FBSPP, janë të aplikueshme edhe për kandidatë të tjerë me nënshtetësi tjetër, veçanërisht ata me kombësi</p>

akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.	shqiptare dhe njohës të gjuhës shqipe. Ndonëse janë kriteret të hapura për këdo, ky program studimi nuk ofrohet në gjuhë të huaja. <i>Evidenca 18 dhe evidence 19.1</i> <i>Evidence nr.18. Manuali për rekrutimin, Aplikimin, regjistrimin dhe transferimin e studenteve</i> <i>Evidenca 19.1. Rregullore e brendshme për transferim dhe regjistrim të studenteve</i>		
Kriteri 8. Institucioni harton politika të ndihmës/ bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.	Sipas akteve dhe dokumentave dhe procedurave të UB del qartë se UB ofron bursa studimi dhe ndihma të tjera, apo stimuj për student në nevojë, apo për student me arritje të veçanta dhe rezultate shumë të larta. Këtë përfundim e konfirmojnë edhe studentët që ndjekin në vite të ndryshme studimi programin Bachelor në FBSPP. Për këtë ka gjithnjë një vendi të posaçëm nga Bordi i Administrimit, sanksionuar në rregulloren e UB. <i>Evidence nr.1. Rregullore e UB</i>		
Konkluzione	<i>GVJ bazuar në dokumentacionin e ofruar nga institucioni si dhe vizitën e realizuar në institucion konkludon se institucioni ka procedura të plote për ndjekjen pranimit regjistrimin apo transferimin e studenteve gjatë gjithë periudhës , por nuk ka mundur të promovojë siç duhet përparësi e këtij programi që të mund ta bëjë atë atraktiv për të rekrutuar një numër më të madh studentesh.</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X	


Standardi V.2	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	Në aktet e universitetit dhe në rregulloret e shkollës, përcaktohen kriteret dhe kërkesa të qarta që kanë të bëjnë me progresin dhe ndjekjen e programeve të studimit. Kërkesat për përparimin akademik, për fitimin e vlefshmërisë së përfundimit të vitit akademik apo për përfitimin e krediteve. Ata studentët njohin kërkesat që duhet të përmbushin si detyrime në programin e çdo lënde, në syllabusat e tyre dhe këto ju bëhen të qarta nga çdo pedagog në seancat e para prezantuese të çdo lënde dhe fillimi të ciklit leksionesh dhe seancash pune. Studentët njohin me saktësi informacionet që kanë të bëjnë me datat e provimeve, me detyrimet pjesore, me kërkesat për detyrimet gjatë semestrit për secilën lëndë dhe në fund të çdo semestri, për ndërprerjen e studimeve apo edhe për transferimin e tyre. Studentët njihen gjithashtu me dokumentacionin që kërkon ana administrative dhe procedurale e fakultetit dhe e universitetit, me dokumentet zyrtare dhe me shërbimet që ofrohen në interes të tyre apo në adresë të tyre. <i>Evidenca 3, rregullore e programit të studimeve Bachelor në FBSPP</i>



<p>Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.</p>	<p>Universiteti dhe fakulteti informojnë rregullisht studentët lidhur me kriteret për njohjen e nivelit të studimeve të mëparshme, të llojit të shkollave, të nivelit të plotë apo të nivelit të pjesshëm të studimeve. UB pranon transferime të studimeve nga degë dhe fakultete ose universitete të tjera brënda vëndit dhe/ose jashtë vëndit, me kushtin që të plotësohen kreditet e parashikuara në ligjin për arsimin e lartë dhe/ose në rregulloren e shkollës dhe në statutin e universitetit</p> <p>Procedurat për transferimet dhe njohjen e krediteve për studimet e mëparshme të studentëve u bëhen të njohura studentëve dhe janë publike.</p> <p><i>Evidenca 19.1, Rregullore e brendshme për Transferimin dhe regjistrimi Evidenca 3, Rregullore e programit të studimit Bachelor në FBSPP Evidenca 18, Manual për rekrutimin, aplikimin, regjistrimin dhe transferimin e studentëve në UB</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>Një nga rubrikat e rëndësishme të rregullores së programit të studimeve të nivelit bachelor, është pjesa e vlerësimit të njohurive dhe format e vlerësimit të dijës. Për këtë janë përcaktuar qartë procedurat, llojet e provimeve, provimet e pjesshme dhe provimet finale për secilën lëndë, mënyrat e organizimit të provimeve, format e hartimit të tezave, procedurat e miratimit të tezave në këndvështrimin administrative dhe akademik, si dhe element të tjerë të nevojshëm.</p> <p>Format e vlerësimit dhe koha e shlyerjes së çdo detyrimi për secilën lëndë dhe për të gjithë studentët, bëhen të qarta në orët e para të kontaktit të pedagogut në auditor me studentët dhe kjo është parashikuar edhe në syllabusat e lëndëve.</p> <p><i>Evidenca 3, Rregullore e programit të studimit Bachelor në FBSPP)</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>Edhe kriteret që duhet të përmbushë çdo student në mënyrë që të fitojë të drejtën të mbrojtë diplomën janë gjithashtu të parashikuara në rregulloren e programit të studimeve të nivelit bachelor. Sipas kësaj rregullore mbrojtja e diplomës është parashikuar me anë të një provimi final, përmbledhës, ri konceptues dhe klasifikues aspo sistemues të njohurive, duke mbajtur parasysh njohuritë bazë me karakter profesional.</p> <p>Departamenti që mbulon programin e studimeve bachelor në FBSPP ka hartuar programin e posaçëm të provimit të formimit, që konsiderohet si provimi final i diplomimit. Në këtë program janë përcaktuar dhe janë përfshirë çështjet kryesore të të gjitha lëndëve të planit mësimor të programit të studimit, si dhe baza e të dhënave që përfshin siç u shpreh më lartë konceptet kryesore të lëndëve bazë të formimit të qëndrueshëm profesional. Ky dokumentacion është konceptuar dhe hartuar në zbatim të kërkesave të VKM 41, datë 24 janar 2018. Në UB kjo procedurë e tërë njihet me termin: Paketa e provës finale në të cilën përcaktohet procedura e provimit final për këtë program që është objekt vlerësimi prej EJ si dhe të programeve të tjera të studimit Master. Paketa përcakton edhe proceduarën e caktimit të temave të diplomave, drejtuesit e tyre, etj kur është fjala për programet e tjera.</p> <p><i>(Paketa e Provës finale, dokumenti shtesë)</i> <i>(Evidenca 3, Rregullore e programit të studimit Bachelor në FBSPP)</i> <i>Takimi me studentët dhe me stafin pedagogjik, nga vizita në institucion të AL)</i></p>

<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.</p>	<p>UB zbaton politikën e vet të rekrutimit. Përdor forma dhe metoda të ndryshme të informimit të kandidatëve potencialë, ka të publikuar në faqen e universitetit udhëzuesit dhe kriteret respektive të pranimit për programin e studimeve bachelor në FBSPP.</p> <p>Pjesë e politikave të rekrutimit dhe informimit janë konferencat me maturantët e shkollave të ndryshme të mesme të vëndit, në qytete të ndryshme dhe organizimi i aktiviteteve dhe veprimtarive të përbashkëta me shkollat e mesme. Një formë e aplikuar shpesh prej UB ka qënë ajo e organizimit të tureve të maturantëve të disa shkollave në ambientet e UB apo ajo e ftesave dhe organizimit të garave midis studentëve të UB me maturantët e shkollave të mesme, kryesisht të kryeqytetit.</p> <p>Ka pasur edhe seancë të informimit dhe bërjes publike të kriterëve të rekrutimit online. Megjithatë mund të thuhet se në programin e studimit bachelor në FBSPP, janë ndërë dukshëm pasojat e Covid-19 dhe të shkëputjes së studentëve nga auditori.</p> <p><i>Evidenca 29: Strategji marketing dhe rekrutimi</i> <i>Takimi me studentët në mjediset e UB si dhe procesverbali i vizitave</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konstaton se UB ka dokumentacion të plotë lidhur me informimin e studentëve për kriteret e pranimit, për detyrimet e tyre lidhur me programin e studimit, për rregullat dhe afatet e detyrimeve, për mbrojtjen e provimit final si dhe për kriteret e hyrjes dhe të transferimit të studimeve.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht X</p>

<p>Standardi V.3</p>	
<p>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënësve dhe mundësitë e punësimit.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.</p>	<p>Nga takimi dhe vizitat në mjediset e UB, nga takimet dhe kontaktet me studentët si dhe nga dokumentacioni i vënë në dispozicion që mbështet raportin e vetëvlerësimit të brendshëm, konkludohet se studentët janë të mirëinformuar, në mënyrë të plotë dhe në detaje, lidhur me strukturën e programit të studimeve, organizimin e studimeve dhe kohëzgjatjen e tyre, duke nënkuptuar limitet dhe hapësirat e lejuara.</p> <p>Format dhe mënyrat e realizimit të këtij objektiivi kanë qënë të ndryshme. Konkludojmë se janë përdorur si informimi në ditët e pritjes dhe të vizitave të studentëve, në ditët e regjistrimit dhe të sqarimit, në takimet informuese dhe sqaruese para marrjes së vendimit përfundimtar për regjistrim. Po kështu, UB ka përdorur informimin gjatë javës së parë të fillimit të studimeve, periudhë kjo në dispozicion edhe për të njohur institucionet, infrastrukturën, mjediset, kodet dhe akseset në përdorimin e gjithë rrjetit të domosdoshëm për studime dhe në dispozicion të studentëve.</p>





	<p>Departamenti ka një koordinator, që është gjithnjë në dispozicion të kërkesave dhe interesave të studentëve i cili ndihmon studentët për çdo nevojë dhe kërkesë. Në mjediset e ambienteve të përbashkëta të universitetit, të holleve, në bibliotekë dhe në hapësirat pranë sekretarive dhe ambienteve të tjera të përbashkëta ka afishe informuese dhe pos tera orientuese për studentët.</p> <p><i>Evidence 19.1, Rregullore e brendshme për Transferimin dhe regjistrimin Vizita në mjediset e UB</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.</p>	<p>Në fillim të çdo semestri, studentët informohen lidhur me programet e lëndëve dhe përmbajtjen lëndrore të secilës lëndë. Po kështu ata informohen edhe në orët e seminare dhe të punëve të drejtuara. Në takimin me grupet e studenteve që ndiqnin programin e studimeve bachelor në FBSPP, rezulton se studentët njihnin saktë kërkesat e moduleve dhe të syllabusave të çdo lënde.</p> <p><i>Evidenca 2.2, Programet lëndore të studimit në FBSPP.</i></p> <p><i>Guida e mësimi online, që ka shërbyer si udhëzues për periudhën e studimeve gjatë pandemisë</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.</p>	<p>Studentët janë të mirë informuar lidhur me mundësitë e punësimit. Niveli i punësimit të studentëve që ndiqnin studimet aktualisht, sidomos ata student që ndiqnin studimet në vitin e dytë dhe të tretë Bachelor, ishin pothuaj mbi 80% të punësuar, me kohë të pjesshme.</p> <p>Po kështu numri i ulët i studentëve për një pedagog, numri relativisht i konsiderueshëm i marrëveshjeve të bashkëpunimit të UB me disa banka, me disa kompani sigurimesh dhe me disa agjenci të pasurive të paluajtshme, janë oferta të mjaftueshme për atë numër të ulët studentësh që ndjekin këtë program studimi. Në UB është ngritur dhe funksionon Bordi i Karrierës si dhe rolin dhe kontributi i dekanit të studentëve është një burim jashtëzakonisht i vlefshëm për këtë kërkesë të standardit.</p> <p>Në UB funksionon zyra e Alumnit dhe zyra e karrierës, të cilat për programin e studimeve Bachelor në FBSPP mund të themi se ka një aktivitet të dobët, të pa konsoliduar. Kjo edhe për faktin se ky është program i ri, në të cilin nuk ka akoma gjeneratë studentësh të diplomuar dhe periudhë kohore të mjaftueshme për të ngritur rrjetin e konsoliduar Alumni, për këtë program. Në rregullore dhe dokumenta janë parashikuar burimet e informimit për mundësitë e punësimit si dhe kanalet e marrjes së këtij informacioni prej studentëve, edhe pse për këtë program studimi nuk ka qënë as nevoja dhe as rasti.</p> <p><i>Evidenca: 20, Evidenca 20.1, Evidenca 20.2, evidence 20.3, evidence 20.4, Evidenca 20.7, evidence 20.8</i></p>
<p>Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>Për të qënë të integruar dhe për të lehtësuar përdorimin e të gjithë infrastrukturave në shërbim të studentëve, UB dhe fakulteti respektiv, sikurse Departamenti dhe strukturat e tjera të administratës si Sekretaria, Dekani i studentëve, i informojnë dhe ju vënë në dispozicion logjistikën, infrastrukturën, aksesin për të shfrytëzuar gjithë rrjetin, mjediset dhe gjithçka në shërbim të programit. Po kështu komunikohet rregullisht informacioni dhe aksesu lidhur me orarin e mësimave dhe me ndryshimet respektive, të gjithë studentët kishin të shkarkuar në telefonat e tyre një</p>

	<p>aplikacion që ju çonte në kohë reale çdo lloj informacioni, njoftimi dhe ndryshimi në oraret e mësimave apo që kishte lidhje me komunikimin. Shkolla ka portalin e vet që funksionon shumë mirë dhe që aksesohet lehtësisht prej të gjithë studentëve. Përdorimi i portalit prej studentëve u demonstrua nga pothuaj gjithë studentet e grupit që morën takim me EVJ. <i>Evidenca 20.5, Portali studentor UB</i> <i>Shënime dhe procesverbali i takimit dhe vizitës në UB</i></p>			
<p>Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.</p>	<p>Gjithë informacioni lidhur me programin e studimit dhe me elementët e tjerë të tij, me integrimin e studentëve dhe informimin e tyre realizohet nëpërmjet sistemit të menaxhimit të brendshëm dhe portalit të posaçëm të UB.</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>UB ka format dhe mënyrat e informimit lidhur me organizimin dhe funksionimin e programit të studimeve. Për këtë studentët kanë akses në rrugë elektronike dhe janë pjesë e platformës së posaçme të informimit të brendshëm.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht	
			X	

<p>Standardi V.4</p> <p>Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.</p>	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.</p>	<p>UB ka evidence dhe statistika të plota, të azhornuara mirë, të përvitshme, me të gjitha të dhënat për numrin e studentëve të regjistruar për çdo vit akademik. Të dhënat janë në nivel vjetor, por edhe statistika që ndjekin dinamikën dhe ecurinë e progresit të secilit student në çdo detyrim dhe provim. Programi është i ri dhe deri tani nuk ka pasur akoma gjeneratë studentësh të diplomuar.</p> <p><i>(Evidenca 3, Evidenca 30, Aneks tabelash, evidence për numrin e studentëve të regjistruar ndër vite në programin e studimeve bachelor në FBSPP)</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mos përfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.</p>	<p>Universiteti disponon statistika për numrin e studentëve të regjistruar. Në tre vitet e fundit akademike numri i studentëve në këtë program studimi është i ulët dhe nuk vihet re ndonjë dinamikë rritëse.</p> <p>Në këtë program studimi nuk ka pasur numër të konsiderueshëm të studentëve të tërhequr nga programi i studimit. Sekretaria mësimore mban dhe ndjek në regjistra të veçanta, sipas formatit të miratuar nga Ministria e Arsimit, të dhënat e çdo student dhe statistikat për gjithë numrin e studentëve në këtë program studimi.</p> <p>Po kështu Sekretaria mësimore ka të dhëna të plota për përmbushjen me sukses apo për rezultatet e studentëve të pasuksesshëm.</p> <p><i>Evidencat respektive</i></p>


	<i>Të dhënat dhe vëzhgimi i regjistrave dhe evidencave</i> <i>Raporti i progresit të programit të studimit</i>			
Kriteri 3. Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.	Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes dy sistemeve të brendshme të universitetit: regjistrave me shënime dhe dokumenteve të printuara dhe nëpërmjet të dhënave të ruajtura dhe konservuara në rrugë elektronike. Të dhënat janë lehtësisht të kontrollueshme dhe të verifikueshme prej ekspertëve të vlerësimit të jashtëm. Të dhënat janë nxjerrë nga dokumentet bazë si dhe nga procesverbalet dhe dokumentet e tjera të hartuara dhe të plotësuara konform akteve dhe rregulloreve të UB. <i>Evidenca 20.5, Shënime nga takimet me studentët dhe nga vizita në sekretari dhe ambiente të tjera të shërbimit studentor</i>			
Kriteri 4. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik të përvitshëm pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.	Të dhënat që grumbullohen dhe përpunohen nga sekretaritë mësimore janë objekt i kontrolleve periodike prej strukturave të tjera eprore, prej zyrës së kontrollit të cilësisë apo prej zyrave mësimore të UB. Po kështu këto të dhëna kryqëzohen edhe me të dhënat që përpunohen prej sistemeve të brendshme të përpunimit dhe menaxhimit. Këto të dhëna mbahen dhe përpunohen me programe të posaçme informatike si Excel, apo programe të tjera statistikore. Këto të dhëna janë bërë objekt i kontrolleve edhe prej zyrave të posaçme të ministrisë së arsimit dhe të agjencive të cilësisë dhe të licencimit. <i>Evidenca 20.5, Portali studentor, Evidenca 20.7, evidenca 20.7.1, Evidenca 20.8, etj</i>			
Kriteri 5. Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.	Departamenti si njësia bazë, harton çdo fund viti akademik raportin e analizës së cilësisë, të rezultateve të arritura, të progresit të programit të studimit dhe të ecurisë së çdo studenti në këtë program. Këto të dhëna kanë shërbyer për të realizuar analizën e departamentit, i cili mbulon edhe programe të tjera studimi. Raporti vjetor i punës ka qënë edhe pjesë e analizave që janë hartuar nga zyra e sigurimit të cilësisë dhe këto analiza dhe statistika i janë përcjellë strukturave të tjera drejtues më të larta të UB. Në disa raste, analizat dhe raportet kanë qënë të shoqëruara edhe me propozime dhe masa për përmirësimin e mëtejshëm të punës. Një nga masat e parashikuara ka qënë që në këtë program studimi, prezantimi i programit të maturantët dhe organizimi i aktiviteteve dhe veprimtarive të përbashkëta të bëhet më mirë i studiuar dhe me një shtrirje kohore më të menduar mirë. <i>Evidenca 34, Analiza vjetore e punës së Departamentit të Ekonomisë, Sipërmarrjes dhe Financës, për vitin akademik 2021-2022)</i>			
Konkluzione	<i>UB ka të dhënat e nevojshme statistikore, mban të dhëna të plotë, i ndjek ato, i analizon, garanton kontrollin dhe saktësinë e statistikave dhe harton periodikisht raporte që kanë të bëjnë me ecurinë e programit dhe progresin e studentëve.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.5	
Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.</p>	<p>Në dokumentat kryesore të UB, si në statutin e universitetit, në rregulloren e universitetit, në rregulloren e zyrave studentore apo të qeverisjes studentore është parashikuar përfshirja dhe angazhimi i studentëve në organet vendimmarrëse, në organet këshilluese apo në bordet e tjera të universitetit, konform ligjeve dhe akteve të tjera ligjore në fuqi.</p> <p>Sipas këtyre akteve, konstatohet se studentët janë të përfshirë si anëtarë të Senatit akademik, të Këshillit të Etikës dhe të Shanseve të barabarta, në Komisionin e sigurimit të brendshëm të cilësisë dhe të standardeve, në Dekanatin e studentëve, në qeverinë studentore dhe sipas dokumentave marrin pjesë edhe në mbledhjet e departamenteve.</p> <p><i>Evidence nr.1. rregullore e UB</i></p> <p><i>Evidence nr.1.4. Statuti i UB</i></p> <p><i>Evidence nr. 20.2. Rregullore e qeverise studentore</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>Studentët e zgjedhur dhe që përfaqësojnë komunitetin studentor në strukturat drejtuese të universitetit dhe në forumet e tjera janë anëtarë të përhershëm. Prezenca e tyre në to është e garantuar, ndërkohë që nuk rezultojnë që zëri studentor është i pranishëm në këto struktura në nivelin e duhur. Prezenca e studentëve në qeverisjen e universitetit dhe përcjellja e zërit të tyre në strukturat drejtuese dhe vendimmarrëse sigurohet edhe nëpërmjet formave të tjera të komunikimit si organizimi periodik i anketimeve dhe i vlerësimit të procesit pedagogjik dhe mësimdhënës.</p> <p>Njësia e sigurimit të cilësisë organizon sondazhe të rregullta dy herë në vit. GVJ shqyrtuan disa ekzemplarë nga këto praktika.</p> <p>Po kështu UB ka parashikuar edhe organizimin e fokus grupeve me studentët apo struktura të tjera, përfshirë edhe me partner të jashtëm me të cilët bashkëpunon në fushat me interes për programin e studimeve bachelor në FBSPP.</p> <p><i>Evidenca 11.8, jep shembuj dhe modele të instrumenteve të vlerësimit).</i></p> <p><i>Evidence nr.1. rregullore e UB</i></p> <p><i>Evidence nr.1.4. Statuti i UB</i></p> <p><i>Evidence nr. 20.2. Rregullore e qeverise studentore</i></p>
<p>Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.</p>	<p>UB ka organizuar takime me spektër të gjerë diskutimi me studentët e programit të studimeve Bachelor në FBSPP, ndërkohë që koha e shkurtër e ekzekutimit të këtij programi studimi nuk ka dhënë mundësinë e organizimit të takimeve dhe diskutimeve mbas diplomimit të tyre.</p> <p>Takimet e organizuara nga njësia e zhvillimit të kurrikulës dhe të cilësisë kanë ndihmuar për të grumbulluar opinionet he sugjerime prej grupeve studentore si dhe për të evidentuar opinionin e tyre lidhur me programin e studimit dhe me mbarëvajtjen e procesit mësimor dhe jetës studentore. Përfundimet e pyetësorëve janë përdorur prej departamenteve si njësi bazë si dhe prej dekanateve dhe strukturave të tjera të njësisë bazë.</p> <p><i>Evidenca 11.8, Instrumente vlerësimi</i></p>

<p>Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/njesisë/ pedagogut përgjegjës.</p>	<p>Studentët kanë mundësitë që të shprehin opinionin e tyre lidhur me vlerësimin e njohurive për secilin prej tyre në provimet e lëndëve. Ata kanë të drejtën e ankimimit dhe të rishikimit të korrigjimit të provimeve, mundësi këto që u janë garantuar prej dokumentave bazë dhe prej praktikës së aplikuar në UB. Pedagogët organizojnë seancë sqaruese lidhur me vlerësimin e njohurive në secilën lëndë dhe kjo është një praktikë e rregullt dhe funksionale në UB. Studentët kanë njëherësh edhe të drejtën të kërkojnë vlerësime nga komisione të posaçme, në se pretendojnë se vlerësimi i tyre nuk ka qënë korrekt. <i>Evidenca 1, Rregullore e UB)</i></p>								
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Studentët janë pjesë e strukturave drejtuese të universitetit, ata e kanë të garantuar këtë prezencë, zëri i tyre institucionalisht është i pranishëm ndërsa në fakt, ata vetë ndihen pak dhe ngrenë shumë rrallë problem. Vlerësimi i tyre është i drejtë, transparent dhe studentët kanë të gjitha hapësirat e nevojshme që të rishikojnë vlerësimin e njohurive të tyre në se në ndonjë rast konstatojnë se pritshmërinë e tyre janë larg rezultatit të arritur. Pedagogët janë të hapur dhe kanë detyrimin të organizojnë seancë sqaruese.</i></p>								
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th data-bbox="611 842 785 913"></th> <th data-bbox="785 842 1011 913">Përmbushet pjesërisht</th> <th data-bbox="1011 842 1228 913">Përmbushet kryesisht</th> <th data-bbox="1228 842 1428 913">Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td data-bbox="611 913 785 958"></td> <td data-bbox="785 913 1011 958"></td> <td data-bbox="1011 913 1228 958"></td> <td data-bbox="1228 913 1428 958">X</td> </tr> </tbody> </table>		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

<p>Standardi V.6</p>	
<p>Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.</p>	<p>Zyrat e posaçme për pritjen, informimin dhe këshillimin e studentëve janë zyra e Alumnit dhe këshillimit të karrierës. Në fillimet e karrierës së tyre akademike pranë UB studentët kanë nevojat e tyre të cilat plotësohen me informacione në vijim. Struktura më e organizuar dhe më funksionale për studentët gjykojmë që është Dekanati i studentëve dhe koordinatori i studentëve. Përgjatë viteve zyrat dhe strukturat që ofrojnë shërbime për studentët ndjekin progresin e studentëve, impenjimet e tyre dhe ju ofrojnë edhe mundësi dhe shanse që shkolla propozon. <i>(Evidenca 19 dhe evidenca 20.1)</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p>	<p>Sekretaria mësimore është e mirë organizuar, e kompletuar me personelin e nevojshëm, ka në përbërje të saj profesionistë që njohin mirë jetën studentore, strukturën e shkollës dhe me eksperiencë në komunikimin dhe pritjen e përcjelljen e studentëve. Për procesin mësimor dhe për programin e studimit bachelor në FBSP studentët kanë të drejtën tu drejtohen edhe departamenteve, tu drejtohen edhe strukturave të tjera, si dhe dekanatit. <i>(Evidenca 1, Evidenca 20.1, Rregullore e funksionimit të zyrave në shërbim të studentëve)</i></p>



<p>Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/ njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>Studentët marrin shërbimin e këshillimit të karrierës. Ata kanë mundësinë të informohen prej zyrave të posaçme pranë UB si dhe prej strukturave të tjera funksionale në shërbim të studentëve.</p> <p>Në mjediset e UB organizohen herë pas here takime me profesionistë të karrierës, me drejtues të kompanive të mëdha të biznesit në Tiranë, me drejtues të bankave, të kompanive të sigurimeve, apo me profesionistë të tjerë të këtyre fushave që kanë bërë karrierë të suksesshme.</p> <p>Studentët orientohen për vende të lira pune dhe për oferta pune që ofrohen nga disa organizata biznesi dhe qendra punësimi, apo nga platforma të ofrimit të posteve të punës. Studentët e UB kanë marrë pjesë edhe në panairë që janë organizuar prej universitetit apo prej institucioneve të tjera të arsimit të lartë, prej dhomave të tregtisë, prej institucioneve të tjera dhe zyrave të punësimit të strukturave të qeverisjes vendore.</p> <p>Në UB funksionon një rrjet që quhet Klubi i karrierës, i cili organizon një sërë aktivitetesh në dobi dhe në ndihmë të studentëve.</p> <p><i>Evidenca 1 dhe Evidenca 20.1)</i></p>			
<p>Kriteri 4. Zyra/ njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.</p>	<p>Zyra e Alumnit dhe e karrierës ka për detyrë të ndjekë ecurinë dhe karrierën e studentëve mbas diplomimit, ndërkohë që për programin e studimit bachelor në FBSPP nuk ka arritur të ketë gjenerata të diplomuara. Kjo zyrë ka qënë e fokusuar më tepër në ndjekjen e progresit dhe të karrierës të studentëve të diplomuar në programet e tjera të universitetit dhe të fakultetit të Ekonomisë, Qeverisjes dhe Drejtësisë.</p> <p><i>(Evidenca 20.1 dhe evidence 20.8)</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Universiteti MB ka zyra të posaçme që ndjekin progresin dhe programin e studimit bachelor në FBSPP. Sekretaria mësimore dhe zyrat e tjera janë të kompletuara dhe kanë punësuar profesionistë dhe punonjës me eksperiencë. Në këndvështrimin institucional progresi i studentëve dhe karriera e tyre ndiqet nga zyra që janë funksionale. Për studentët e programit bachelor në FBSPP nuk ka gjenerata të diplomuara dhe nuk ka informacione që lidhen me rrjetin Alumni të UB.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përbushet plotësisht</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V</p>	<p>Përbushet plotësisht</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>
--	------------------------------------	-------------------------------------	------------------------------------	---

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR

Standardi VI.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.</p>	<p>UB ka aplikuar politika që synojnë zhvillimin dhe përdorimin e metodave bashkëkohore të mësimdhënies, inovative që synojnë përdorimin e teknikave të reja dhe bashkëkohore në harmoni me teknologjinë, me progresin teknik dhe në mënyrë të veçantë me teknikat e reja të komunikimit. Të gjitha këto përkrahin dhe nxisin përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies.</p> <p>Provë e përdorimit të metodave të reja dhe bashkëkohore që synojnë nxitjen dhe përmirësimin e mësimdhënies është organizimi i programit të studimeve Bachelor në FBSPP përgjatë periudhës së pandemisë. UB hartoi për këtë situatë specifike dhe të veçantë udhëzues dhe rregullore të reja që garantonin vijimësinë e mësimdhënies.</p> <p>Për këtë qëllim janë hartuar manual të mësimit online, guida për studentët dhe pedagogët si dhe udhëzues të ndryshëm.</p> <p><i>Evidencat 11.2, 11.3 dhe 11.4 si dhe Evidencat 17, 17.1 dhe 17.2, Evidenca 16.1.</i></p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.</p>	<p>Edhe për programin e studimeve Bachelor në FBSPP, pranë UB ka struktura të posaçme që përgjigjen për ndjekjen dhe monitorimin, apo vlerësimin periodik të aftësive mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik, sikurse janë zyra e zëvendës rektorit, zyra e menaxhimit dhe e vlerësimit të performancës, si dhe njësitë bazë të institucionit.</p> <p>Po kështu edhe njësitë e tjera si zyra e zhvillimit të kurrikulës dhe të cilësisë si dhe zyra e menaxhimit dhe vlerësimit të performancës, monitorojnë procesin e mësimdhënies, ndjekin respektimin e programeve, të vijueshmërisë, të plotësimit të javëve mësimore dhe elementëve të tjerë të parashikuar.</p> <p><i>(Evidenca 12, Rregullorja e Vlerësimit dhe administrimit të performancës, Evidenca 12.1 Formulari për transparencë, Evidenca 11.8, Instrumente Vlerësimi, Evidenca 11.9, Vlerësimi i mësimdhënies kolegë me kolegë, Evidencat 17, 17.1, 17.2, etj)</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.</p>	<p>UB vlerëson mendimin dhe opinionin e studenteve në lidhje me vlerësimin periodik të formave të mësimdhënies. Për këtë janë organizuar pyetësorë dhe fokus grupe. Sikurse është vënë në dukje edhe në kriteret e ndryshme të standardeve të fushës 5, UB ka organizuar dy herë në vit pyetësorë me studentët, si rregull në fund të çdo semestri. Ata vlerësojnë lëndën, mësimdhënien, metodat, aplikimin dhe alternimin e metodave të transmetimit të dijeve, lidhur me literaturën, dhe elementët e tjerë.</p> <p><i>(Evidenca 11.8)</i></p>
<p>Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>Strukturat përgjegjëse për cilësinë dhe monitorimin e mësimdhënies në UB janë krijuar në përputhje me ligjin 80/2015 si dhe me atë që është parashikuar rregullisht në dokumentat kryesore të UB. UB ka dy struktura përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë: Komisioni i</p>

	sigurimit të standardeve dhe Njësia e zhvillimit kurrikular dhe cilësisë. Ato bëjnë publike rezultatet e vlerësimit të cilësisë, me gjithë që nuk rezultojnë që këto struktura të kenë bërë raporte dhe analiza të posaçme për programin e studimeve Bachelor në FBSPP.		
Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	UB përdor metoda dhe forma që synojnë promovimin e shembujve të mirë, të praktikave të mira, përdor forma që nxitin personelin akademik që përmirësojnë mësimdhënien dhe janë krijuar, që bashkëpunojnë me struktura të tjera dhe promovojnë edhe arritjet më të mira midis studentëve. Gjatë periudhës së pandemisë, prej UB u vu në funksionim metoda e vet raportimit prej të gjithë personelit akademik dhe pedagogjik lidhur me progresin por edhe problematikën që nxori forma e re e mësimdhënies online. Nëpër departamente janë praktikuar analiza periodike të mësimdhënies. <i>Ndërkohë nuk rezultojnë që të jenë bërë analiza të posaçme për programin e studimit bachelor në FBSPP nga departamenti apo nga Dekanati i Fakultetit.</i> (Evidenca 34, Analiza vjetore e punës së Departamentit të Ekonomisë, Sipërmarrjes dhe Financës, për vitin akademik 2021-2022)		
Konkluzione	Universiteti ka struktura të posaçme që ndjekin dhe garantojnë ecurinë e programit të studimit, si dhe përmirësimin e mësimdhënies, studentët janë të përfshirë në këtë proces dhe përfshirja e tyre është e garantuar, rezultatet e mësimdhënies si rregull bëhen publike, megjithëqë që për programin e studimit bachelor në FBSPP nuk ka rezultate të tilla, si dhe promovohen shembujt e mirë dhe praktikave të përmirësimit të mësimdhënies.		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X	

Standardi VI.2	
Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	UB ka hartuar dhe ndjek politika që synojnë ndjekjen dhe përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies, në përputhje me kërkesat e ligjit për arsimin e lartë dhe të akteve të tjera në fuqi, të akteve rregullatore dhe institucionale. Janë krijuar dy strukturat në nivel universiteti, Komisioni i Sigurimit të Standardeve dhe cilësisë dhe Njësia e Zhvillimit kurrikular dhe cilësisë, të cilat kanë gjithashtu aktet e tyre rregullative, siç janë rregulloret, në të cilat janë përcaktuar detyrat, funksionet, objekti i veprimtarisë, etj. (Evidenca 12 dhe Evidenca 12.1, si dhe evidencat 17, 17.1, 17.2, 17.3 etj)
Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku	Institucioni i ka krijuar strukturat e posaçme të sigurimit të brendshëm të cilësisë, të cilat sikurse u shpjeguan në arsyetimin për kriterin 1, bashkëpunojnë ngushtë edhe zyrën e Menaxhimit dhe të Administrimit të Performancës, Zyrën e menaxhimit të burimeve njerëzore, Zyrat e Alumnit, të pranimeve, Dekanin e studentëve dhe njësitë kryesore. Arritjen e objektivave UB e bazon të bashkëpunimi dhe harmonizimi i

përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.	veprimtarisë së këtyre strukturave që janë të ngarkuar secila për element të veçantë të lidhura me sigurimin e brëndshëm të cilësisë. (Evidenca 5, evidenca 5.1)								
Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.	Ka një sërë elementësh që shërbejnë për vlerësimin e cilësisë, si formularë, pyetësorë që plotësohen prej studentëve në mënyrë anonime, kontrole paralele, kontrole vertikale prej njësisë bazë, kontrole dhe organizime të seancave të veçanta prej njësisë së zhvillimit të karrierës dhe cilësisë, kontrole dhe vlerësime kolege me kolegë, apo raportet e vlerësimit të pedagogëve prej studentëve. Në kuadër të vlerësimit të jashtëm, UB ka hartuar raportet e vetëvlerësimit dhe i është nënshtruar herë pas here vlerësimit periodik prej agjencive të specializuara apo vlerësimit krahasues me nivelin e institucioneve të tjera të arsimit të lartë. (Evidencat 11.8, 11.9 dhe 12.1)								
Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.	Një nga treguesit e matshëm dhe konkret që përdor UB për vlerësimin në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin e gjendjes të arritjeve dhe të dobësive, ka shërbyer raporti që harton secili anëtar i stafit akademik për procesin e mësimdhënies dhe për ecurinë e këtij procesi. Ky raport shpreh vlerësimin e secilit pedagog në mësimdhënie, në projekte, në punë kërkimore, në punë administrative dhe angazhime të tjera profesionale. Po kështu lidhur me angazhimin e stafit, njësia bazë dhe njësia kryesore marrin edhe informacione të tjera të siguruar nga sekretaria mësimore, nga zyra e menaxhimit të burimeve njerëzore dhe burime të tjera. <i>Nuk na rezulton që UB të ketë evidentuar të meta dhe dobësi në procesin e sigurimit të mësimdhënies dhe të realizimit të të gjithë programit të studimeve bachelor në FBSPP.</i> (Evidenca 7)								
Konkluzione	<i>Universiteti është i angazhuar për sigurinë dhe përmirësimin e cilësisë së brendshme të mësimdhënies, ka strukturat e posaçme që realizojnë dhe ndjekin këtë element, përdor tregues të matshëm dhe të dukshëm Megjithatë, nuk rezulton që të ketë evidentuar të meta dhe dobësi në programin e studimit që vlerësohet prej EVJ.</i>								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th></th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> <td></td> </tr> </tbody> </table>		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X	
	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
		X							

Standardi VI.3	
Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të	UB ka hartuar një dosje të plotë me material të karakterit dokumentar, me hapat, proceset dhe studimin e nevojshëm që kanë shërbyer për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e programit të studimit të ciklit të barë, bachelor në FBSPP. Në këto material si dhe në takime dhe veprimtari të organizuara zyrtarisht janë evidentuar arritjet, të metat dhe dobësitë, si dhe janë vënë ato në dukje për organet drejtuese të

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel: +355 (04) 22-43423



Web site: www.ascal.al

Faqe 52

<p>parë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	<p>brëndëshme si dhe për institucionet e jashtme që kanë për mision akreditimin e programeve apo akreditimin institucional.</p> <p>Njësia bazë, departamenti respektiv e ka drejtuar këtë proces. Nuk rezultojnë që Departamenti të ketë bërë një bilanc të plotë me arritjet dhe dobësitë e programit të studimit bachelor në FBSPP, me argumentin se programi është ende i pa akredituar dhe se njësia bazë nuk ka të drejtën të ndryshojë qoftë edhe brënda limit ligjor të lejuar prej 20% as syllabusat e lëndëve dhe as strukturën e lëndëve dhe të moduleve të të gjithë programit të studimit. Projektet dhe propozimet për hapjen e programeve të reja fillojnë në njësinë bazë dhe në bashkëpunim me njësinë e zhvillimit kurrikular dhe të cilësisë.</p> <p><i>(Evidencat 34, Evidencat 11.8.1 dhe evidence 11.8.2)</i></p> <p><i>Shënime dhe procesverbal i mbajtur në takimet e vizitës të realizuar në UB, respektivisht takimet me grupin e vetëvlerësimit, me drejtuesit dhe stafin akademik.</i></p>
<p>Kriteri 2. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.</p>	<p>Kur ka qënë fjala për raporte të tjera të vlerësimit të brëndshëm për programe të tjera studimi apo për rezultatet e akreditimit institucional, ato kanë qënë diskutuar në të gjitha njësitë e UB.</p> <p><i>Për programin e studimit bachelor në FBSPP nuk ka ndonjë raport të posaçëm vlerësimi.</i> Departamenti dhe njësia kryesore kanë opinionin që mbas procesit të akreditimit të programit të studimit do të ketë një proces reflektimi dhe përmirësimi duke evidentuar arritjet dhe të metat, dhe duke inkurajuar praktikën e mira dhe duke përmirësuar dhe korigjruar të metat.</p> <p><i>(Takimet në UB, procesverbali i takimeve)</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testimet lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testimet ndërinsticionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>UB ka përdorur herë pas here praktikën dhe metodat e drejtpërdrejta të vlerësimit të mbarëvajtjes së programit të studimit bachelor në FBSPP. Metodën e ndryshme që janë përdorur janë të njëjta me ato që përdoren për të gjitha programet e studimit.</p> <p>Përveç vet raportimit dhe analizave individuale apo në grup lëndësh të pedagogëve, janë realizuar edhe metoda të tjera si raportimi gojor i pedagogëve, vlerësimi me pyetësorë të studentëve, analizat dhe takimet mujore të departamentit, raportimet përmbledhëse dhe analizues nga drejtuesi i njësisë bazë, nga njësia e zhvillimit kurrikular, nga kontrollet paraprake të tezave dhe formave të vlerësimit të studentëve, etj.</p> <p><i>(Procesverbali i takimeve dhe vizitës në UB)</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta</p>	<p>Metodat e tërthorta të vlerësimit të programit të përdorur kanë qënë ato që kanë të bëjnë me pyetësorët realizuar me studentët, monitorimi i orëve të mësimit dhe i gjithë procesit të mësimdhënies, analiza e rezultatit të studentëve në provime, vëzhgimet e praktikave, mbikëqyrja e punimit të diplomave, etj.</p>

<p>vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfuara nga ky program.</p>	<p>Në programin në fjalë, ka një numër të konsiderueshëm të studentëve të punësuar dhe kontaktet me punëdhënësit shërben gjithashtu si një metodë e vlerësimit të tërthortë, alternative, të programit të studimit bachelor në FBSPP. Megjithatë që përmendet shpesh se mbahen kontakte shumë të mira me punëdhënësit e studentëve të programit, nuk rezulton që për këtë të ketë gjurmë, të ketë ndonjë material apo praktikë që tregon shembullin e një praktike të mirë. Ndoshta kjo edhe për faktin se programi i studimit është i ri dhe në konsolidim e sipër. (Procesverbali i takimeve të GVJ në UB, takimet me drejtuesit dhe studentët)</p>		
<p>Konkluzione</p>	<p>Njësia bazë dhe ajo kryesore përdorin analiza dhe metoda të drejtpërdrejta për vlerësimin dhe ecurinë e programit të studimit. Ato përdorin edhe metoda të tërthorta, ndër të cilat më të rëndësishme konsiderohen kontaktet dhe analizat e posaçme me punëdhënësit potencialë të studentëve të programit. Nuk rezulton të ketë praktika, gjurmë dhe analiza të posaçme të këtyre metodave për programin e studimit Bachelor në FBSPP.</p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
		X	

<p>Standardi VI.4</p>	
<p>Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Në dokumentat e institucionit është parashikuar prezenca dhe kontributi i aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm, të interesuar për sigurimin e cilësisë dhe të përmirësimit të jashtëm të saj. Në komisionin e sigurimit të brendshëm të cilësisë është parashikuar që duhet të bëjnë pjesë 5 anëtarë, nga të cilët 4 anëtarë duhet të jenë nga personeli akademik, ndërsa një anëtar nga studentët. Prezenca e aktorëve të jashtëm ka qënë ose e papërfillshme ose e munguar në rastin e programit të studimit bachelor në FBSPP. Kjo kryesisht për shkak të periudhës së Covidit që kanë bashkëshoqëruar këto tre vite akademike të fillimit dhe realizimit të këtij programi studimi. (Evidencat 17 dhe evidence 20) (Shënime dhe procesverbali i takimeve të EVJ në UB)</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>Në rregullore dhe aktet e tjera janë të përcaktuara janë saktësuat përgjegjësitë dhe detyrat konkrete për njësinë kryesore, për individët, për anëtarët e komisioneve dhe të njësisë së zhvillimit kurrikular dhe të sigurimit të brendshëm të cilësisë. Në realitet nuk ka pasur raste të analizës dhe përcaktimit të ndonjë përgjegjësie të drejtpërdrejtë apo të deleguar për programin e studimit, përgjatë periudhës që nga fillimi i këtij programi.</p>

	<i>(Procesverbali i takimeve në institucion, opinionet he mendime të shprehura nga stafi, njësia e kurrikulave dhe drejtues të programit).</i>		
Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësive bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentëve e programit të studimit.	Njësia e zhvillimit të kurrikulave dhe sigurimit të cilësisë ka bashkëpunuar me njësinë kryesore. Ky bashkëpunim ka qënë më shumë gojor dhe nëpërmjet takimeve dhe analizave me prezencë të stafëve dhe personelit. <i>Nuk rezulton të ketë ndonjë analizë të dokumentuar dhe të ketë lënë gjurmë për përcaktimin e përgjegjësive dhe detyrave që rrjedhin nga ndonjë analizë konkrete.</i> <i>(Procesverbali i takimeve dhe vizitave të EVJ në UB)</i>		
Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.	Në të gjithë veprimtarinë lidhur me vlerësimin dhe analizën e ecurisë së programit të studimit, respektohet liria dhe integriteti akademik i pedagogëve, shmanget shkelja e të drejtave të individit, respektohet barazia midis stafit dhe studentëve, apo nuk është lejuar dhe nuk lejohet ndonjë shfaqje tjetër që shpreh diskriminim apo mosrespektim. <i>(Statuti, Procesverbali i takimeve dhe vizitave), (Evidenca 1.4)</i>		
Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.	Në proceset e vlerësimit të sigurimit të cilësisë dhe analizave të kësaj natyre UB ka marrë edhe opinionin e pedagogëve të jashtëm. Ndërkohë nuk është ftuar ndonjë ekspert i posaçëm i jashtëm që të ketë kontribuar me opinionet apo analizat e tij në vlerësimin e programit të studimit Bachelor në FBSPP. Kjo ka qënë e kufizuar edhe prej kohës dhe zhvillimeve të papërshtatshme të shkaktuara prej pandemisë në këto vite të ekzekutimit dhe fillimit të programit të studimit. <i>(Procesverbali i takimeve dhe vizitës së EVJ në UB)</i>		
Konkluzione	<i>Institucioni ka parashikuar në dokumentat e tij përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm në vlerësimin dhe përmirësimin e cilësisë së programit të studimit. Partnerët e jashtëm dhe ekspertët e jashtëm nuk kanë pasur dhe nuk kanë ndonjë rol të dukshëm dhe të evidentuar. Koha e shkurtër dhe e ngarkuar me epideminë e Covid 19 nuk ka ndihmuar në këtë process.</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X	



Standardi VI.5

Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të	Veprimtaria e UB në kuadër të sigurimit të brendshëm të cilësisë dhe politikat apo strategjitë në këtë kuadër janë të hapura, janë bërë publike në aktet kryesore të universitetit dhe publikohen në website e universitetit.

<p>Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.</p>				
<p>Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</p>	<p>Në rregulloren e njësisë së zhvillimit kurrikular dhe të cilësisë janë parashikuar parimet kryesore mbi të cilat ndërtohet sigurimi i brendshëm i cilësisë. Raportet dhe vlerësimet e realizuara nga kjo njësi janë të hedhura dhe gjenden në faqen e universitetit. <i>Nuk ka raporte apo analiza që të lidhen me programin studimit bachelor në FBSPP.</i></p>			
<p>Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.</p>	<p>Njësitë bazë në përgjithësi dhe njësia bazë që mbulon dhe drejton programin e studimit bachelor në FBSPP, sipas rasteve angazhohen me vendime të veçanta sipas rastit të Njësisë kryesore ose të rektoratit që të ndërtojnë planin e masave që synojnë plotësimin e mangësive dhe përmirësimin e situatave kur ka qënë rasti. <i>Nuk ka pasur praktika dhe akte të kësaj natyre për programin që vlerësohet.</i> <i>(Evidenca 11.11 dhe evidence 11.12)</i></p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Si rregull në aktet e UB parashikohet përmirësimi i vazhdueshëm i programit të studimit, nëpërmjet rishikimit të syllabusave, nëpërmjet të drejtës së pasurimit dhe përmirësimit të metodave të mësimdhënies që nënkupton deri në 20% të përmbajtjes së tyre. Sipas udhëzimeve këto ndryshime mund të bëhen vetëm një herë përgjatë periudhës tranzitore nga një proces akreditimi të tjetri. Institucioni punën përgatitore dhe hartimin e raportit të vetëvlerësimit e konsideron si proces përmirësimi dhe reflektimi apo korrigjimi të të metave. Drejtuesit e njësisë bazë dhe ata të njësisë kryesore kanë parashikuar që mbas procesit të akreditimit mund të bëjnë një rishikim të programit të studimit me objektivë përmirësimin e tij. <i>(Procesverbali i takimeve dhe vizitave në institucion).</i></p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Departamenti, njësia kryesore dhe strukturat e tjera kanë organizuar dhe organizojnë herë pas here veprimtari periodike me studentët por edhe me personelin për të informuar dhe ndërgjegjësuar gjithë pjesëmarrësit lidhur me nevojën dhe domosdoshmërinë e përmirësimit të cilësisë. Përgjatë periudhës së Covidit thuhet se këto veprimtari janë kryer online, ndërkohë që nuk rezultojnë të ketë prova material dhe shkresore që të kenë lënë gjurmë veprimtari të tilla.</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Në përgjithësi, veprimtaritë, analizat, proceset e ndërmarra për përmirësimin e brendshëm të cilësisë kanë qënë publike, transparente dhe të efektshme. Parimet mbi të cilat ndërtohet kjo veprimtari janë të sanksionuara në aktet e universitetit. Nuk rezultojnë që të ketë raporte, analiza dhe akte të tjera të publikuara për këtë program studimi. Për këtë ka ndikuar edhe periudha e Covid-it. Herë pas herë institucioni organizon veprimtari për të komunikuar këto rezultate, por që për këtë program studimi nuk ka ndonjë praktikë të tillë.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në “Financë, Bankë, Sigurime dhe Pasuri të Paluajtshme” ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë “Universiteti Barleti”

Pikat e forta dhe afirmime:

1. Studentët e pranuar në këtë program studimi, megjithëse në numër shumë të ulët, kanë mesatare të kënaqshme të nivelit të studimeve të maturës. Ata kanë arritur në këtë program studimi me mesataren 8.48 çka është premtuese.
2. Infrastruktura të re, moderne, të mirëpajisura, funksionale dhe në të cilat studentët janë të mirëintegruar dhe të gjithëpërfshirëse
3. Grupet e studentëve që ndjekin programin e studimit bachelor në Financë, Bankë, Sigurime dhe Pasuri të paluajtshme, ishin të motivuar dhe ndiqnin me shumë interes programin e studimit,
4. Jeta e gjallë studentore në mjediset e brendshme të universitetit në të cilën janë përfshirë edhe studentët e programit të studimit bachelor në FBSPP
5. Ngarkesa e ulët e numrit të studentëve për një pedagog, për shkak të numrit shumë të ulët të studentëve që janë rregjistruar dhe ndjekin programin e studimit, është faktor që krijon lehtësi të punës me studentët dhe premtonte rezultate të larta,
6. Universiteti ka një numër të konsiderueshëm marrëveshje bashkëpunimi dhe këmbime me shkollat të tjera dhe me partner ndërkombëtarë
7. Niveli relativisht i lartë në dy vitet e fundit të studentëve që ndjekin programin e studimit, të cilët janë në marrëdhënie pune, krijon imazh të mirë dhe premtonte për rezultate të kënaqshme

Pika të dobëta:

1. Niveli shumë i ulët i numrit të studentëve në këto tre vitet e para akademike nuk ka dhënë mundësinë që programi i studimit të konsolidohet edhe në këndvështrimin e imazhit dhe të ndjekjes. **(Standardi V.1, kriteri 5)**
2. Promovimi i dobët ndër vite i programit të studimit, ka sjellë mos njohjen e këtij programi nga maturantët e shkollave të mesme, për veçoritë që ka programi i studimit, të spektrit të gjerë të studimit dhe të faktit që është pothuaj program studimi unik në Shqipëri. **(Standardi V.1, kriteri 5)**
3. Një lloj paqëndrueshmërie e stafit përgjatë kësaj periudhe që nga njëra anë programi ka qënë i ri dhe nga ana tjetër stafi ka lëvizur, ndërkohë që kjo periudhë është shoqëruar edhe me problemet e Covid-19. **(Standardi V.1, kriteri 1)**
4. Mungon një përditësim dhe freskim në syllabusat gjë që tregon se njësia bazë nuk ka qënë fort e motivuar, për shkak të numrit të ulët të studentëve. **(Standardi VI.1. Kriteri 5)**

Rekomandime:

1. Promovim intensiv i programit të studimit dhe angazhim maksimal i personelit akademik dhe administrativ të Universitetit “Barleti” me qëllim rritjen e numrit të studentëve në këtë program.
2. Konsolidimi i mëtejshëm i stafit akademik të programit nëpërmjet rritjes në numër por edhe në kualifikim akademik të PAE.
3. Ulja e numrit të PAK të angazhuar në këtë program.
4. Përditësimi i syllabusve me zhvillimet më të fundit në tregun financiar.
5. Ndërmarrja e analizave të posaçme për programin e studimit Bachelor në “Financë, Bankë, Sigurime dhe Pasuri të Paluajtshme” nga Departamenti apo nga Dekanati i Fakultetit me qëllim evidentimin e problematikave në mësimdhënie dhe mësimnxënie.

Conclusions of the Evaluation of the first cycle Bachelor's study program in "Finance, Banking, Insurance and Real Estate" offered by the Higher Education Institution "Barleti University"

Strengths and affirmations:

1. Students admitted to this study program, although in very low numbers, have satisfactory averages of their high school results. They have come to this study program with an average of 8.48 what is promising.
2. New, modern, well-equipped, functional infrastructure in which students are well integrated and inclusive.
3. The groups of students following the bachelor study program in Finance, Banking, Insurance and Real Estate were motivated and followed the study program with great interest.
4. Vibrant student life in the internal environments of the university in which the students of the bachelor's study program at FBSPP are also included
5. The low load of the number of students for a lecturer, due to the very low number of students who are registered and follow the study program, is a factor that creates ease of working with students and promises high results.
6. The University has a significant number of cooperation agreements and exchanges with other schools and international partners.
7. The relatively high level in the last two years of students following the study program, who are in a working relationship, creates a good image and promises satisfactory results.

Weak points:

1. The very low level of the number of students in these first three academic years has not given the opportunity for the study program to be consolidated in terms of image and attendance. **(Standard V.1, criterion 5)**
2. The weak promotion of the study program over the years has led to the lack of recognition of this program by high school graduates, for the features of the study program, the wide spectrum of study and the fact that it is almost a unique study program in Albania. **(Standard V.1, criterion 5)**
3. A kind of instability of the staff during this period since on the one hand the program was new and on the other hand the staff moved, while this period was also associated with the problems of Covid-19. **(Standard V.1, criterion 1)**
4. There is a lack of updating and refreshing in the syllabuses, which shows that the basic unit has not been strongly motivated, due to the low number of students. **(Standard VII. Criterion 5)**

Recommendations:

1. Intensive promotion of the study program and maximum commitment of the academic and administrative staff of Barleti University with the aim of increasing the number of students in this program.
2. Further consolidation of the academic staff of the program through an increase in the number but also in the academic qualification of full time academic staff.
3. Reducing the number of part time academic staff engaged in this program.
4. Updating the syllabus with the latest developments in the financial market
5. The undertaking of special analyzes for the bachelor's study program in "Finance, Banking, Insurance and Real Estate" by the Department or by the Dean's Office of the Faculty in order to highlight the problems in teaching and learning.

Shkalla e përbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Përbushen plotësisht	Përbushen pjesërisht	Përbushen kryesisht	Përbushen plotësisht
I. OFRIMI, i PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI i PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT			X	
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI i CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR			X	
VLERËSIMI TËRËSOR				X

